



2012

RAPORT VJETOR





2012
raporti vjetor

© 2013

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.
Adresa: Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10, P.O.Box. 8363, Tiranë
Tel: +355-4-2251355 / 6
Faks: +355-4-2250686
E-mail: amf@amf.gov.al
Web: www.amf.gov.al

Përmbajtja



Fjala Përshendetëse e Kryetares **6**

PJESA I **AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI 7**

Kapitulli 1 **Organizimi i AMF 7**

- 1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore 7
- 1.2 Drejtimi dhe organizimi 8
- 1.3 Buxheti 16
- 1.4 Ndryshime në kuadrin rregullues të AMF-së 17

Kapitulli 2 **Aktiviteti i AMF 19**

- 2.1 Aktiviteti rregullator 19
- 2.2 Aktiviteti licencues 21
- 2.3 Aktiviteti mbikëqyrës 31
- 2.4 Teknologjia e informacionit 45
- 2.5 Bashkëpunimi institucional 48
- 2.6 Integrimi Evropian 56
- 2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca 61

Kapitulli 3 **Mbrojtja e Konsumatorit 64**

PJESA II **TREGJET E MBIKËQYRURA 67**

- II. 1 Tregu i sigurimeve 67
- II. 2 Tregu i letrave me vlerë 78
- II. 3 Tregu i pensioneve private vullnetare 82

Sfida dhe prioritete të AMF-së 84

SHTOJCA 88

- A: Struktura e AMF
- B: Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin financiar nën mbikëqyrje
- C: Lista e institucioneve të mbikëqyruara
- D: Anëtarësime e marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara nga AMF
- E: Tabela statistikore

Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Enkeleda Shehi, Kryetare e
Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

I nderuar lexues i Raportit Vjetor 2012,

Prej disa vitesh bashkësia ndërkombëtare punoi për kapërcimin e krizës dhe njëherësh për ndërtimin e një kuadri ambicioz rregullator e mbikëqyrës, që përbën sfidë reale për autoritetet rregullatore financiare, përfshi AMF-në. Ky kuadër ndërkombëtar në ndryshim po gjen pasqyrimin e tij në veprimtarinë e AMF-së, pavarësisht shkallës relativisht të ulët të integritit të tregut financiar shqiptar me atë botëror, si dhe ndikimit më periferik të krizës financiare botërore në tregjet financiare në Shqipëri.

Së pari dhe mbi të gjitha, në AMF u konsolidua besimi, se forcimi i pavarësisë së autoritetit rregullator përbën një faktor të rëndësishëm në përballimin e sfidës së zhvillimit të kuadrit mbikëqyrës. Më 31 tetor 2012, AMF organizoi konferencën e parë ndërkombëtare ku u trajtua pavarësia e rregullatorit financiar, parë nga perspektiva e integritit në BE dhe mësimet të nxjerra nga kriza më e fundit financiare botërore. Ky aktivitet u shndërrua në një forum diskutimi pikëpamjesh të ekspertëve dhe të kryetarëve të autoriteteve rregullatore, që përfaqësonin tregje nga SHBA dhe Evropa. Mesazhet e transmetuara dhe përfundimet e kësaj konference i shërbyen AMF-së për të formuluar në mënyrë më të plotë e të qartë ndryshimet në ligjin për AMF-në. Këto ndryshime, të dërguara në Oeveri, i shërbejnë rikthimit të pavarësisë Autoritetit dhe krijimit të mekanizmave mbrojtës për të.

Së dyti, zgjerimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe shtimi i kompleksitetit në to krijon sfida të vazhdueshme për AMF-në. Prandaj, një pjesë e konsiderueshme e burimeve njerëzore dhe financiare në AMF i dedikohen strategjive dhe projekteve që lidhen me përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës e rregullator.

Së treti, administrimi i procesit të liberalizimit të tarifave të sigurimit të detyrueshëm në tregun e sigurimeve ka patur vëmendje të konsiderueshme gjatë vitit 2012. Ky proces kërkoi reagimin e AMF-së për të hartuar dhe miratuar kuadrin rregullativ të nevojshëm, si dhe vigjilencë mbikëqyrëse në lidhje me vlerësimin sa më real të primeve të riskut. AMF synon të mbrojë konsumatorët duke nxitur atë që e kemi pagëzuar si "konkurrencë të shëndetshme" dhe duke punuar në dy aspekte: konsumatorëve t'u ofrohen produkte me çmim konkurrues dhe shoqëritë e sigurimit të kenë nivele të mjaftueshme provigjonesh e garancish, që të mund të kryejnë pagesat e detyrimeve që lindin për dëmet shkaktuar konsumatorëve.

Së katërti, do të përmendja shtimin e operatorëve të licencuar në tregjet financiare nën mbikëqyrje, prirje e cila tregon për rritjen e vëmendjes së investitorëve në tregjet financiare në vend.

Sfida më e rëndësishme që ka AMF është shtrirja e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun në tregjet e letrave me vlerë dhe të fondeve të pensioneve vullnetare private. Strategjia e formuluar në AMF është e një natyre komplekse. Ndiej krenari për seriozitetin dhe këmbënguljen e punonjësve të AMF-së në zbatimin e saj, si dhe mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare dhe të Bordit në këtë proces.

Shpresoj që lexuesi të gjejë në këtë raport një burim të vyer informimi dhe edukimi,

Me konsideratë,

Enkeleda Shehi

PJESA I

AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI



Kapitulli 1

Organizimi i AMF

- *Mbrojmë konsumatorët*
- *Promovojmë tregjet*
- *Zbatojmë ligjin*

1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si institucion juridik publik, i pavarur që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është një organizëm rregullator, i konsoliduar, për të mbikëqyrur tregjet financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare në Shqipëri, që në vijim do t’u referohemi si tregje financiare nën mbikëqyrje.

Misioni

Misioni i AMF-së është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, AMF udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve;
- Nxitja e transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje;
- Sigurimi i respektimit të ligjit.

Funksionet kryesore të AMF-së

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja:

- e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
- e tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg;
- e tregut të pensioneve vullnetare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve vullnetare, të ofruara nga subjektet e licencuara për të operuar në këtë treg;
- e veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës.

1.2 Drejtimi dhe organizimi

Bordi i AMF-së

Bordi është organi drejtues dhe vendimmarrës i AMF-së. Të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afat 5-vjeçar. Gjatë vitit 2012, Bordi i AMF-së pësoi disa ndryshime. Aktualisht, përbërja e Bordit të AMF-së paraqitet si më poshtë:

▪ Enkeleda SHEHI	<i>Kryetare *</i>	▪ Riçard MARKU	Anëtar
▪ Mati PEPA	Nënkryetar **	▪ Kestrin KATRO	Anëtare
▪ Enkela IDRIZI	Nënkryetare	▪ Astrit HADO	Anëtar
▪ Miranda RAMAJ	Anëtare		



Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare


Bordi i AMF-së, në përmbushje të funksioneve të tij gjatë vitit 2012 ka zhvilluar 12 mbledhje dhe ka marrë 172 vendime. Tabela në vazhdim pasqyron numrin e vendimeve të Bordit të AMF-së të ndarë sipas llojeve.

Vendimet e Bordit kanë synuar realizimin e një mbikëqyrjeje efektive të tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe atij të pensioneve private

vullnetare. Ndër vendimet më të rëndësishme janë ato që lidhen me gjallërimin e tregut nëpërmjet licencimit të subjekteve. Të tilla janë licencimi i shoqërisë së re në sigurimin e Jo-Jetës, licencimi i profesionistëve në sigurime, licencime të fondeve të investimit si dhe licencime për të ushtruar veprimtari brokerimi në tregun e letrave me vlerë.

Shënim: * Vendimi nr. 10/2012 datë 16.02.2012 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë liroi nga detyra e Nënkryetares së Bordit, Znj. Enkeleda Shehi dhe e zgjodhi në detyrën e Kryetares së Bordit të Autoritetit.

** Vendimi nr. 11/2012 datë 16.02.2012 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë zgjodhi Z. Mati Pepa në detyrën e anëtarit të Bordit, në pozicionin, Nënkryetar i Autoritetit, drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.



Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit

Llojet e vendimeve	Numër
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura ²	137
Vendime për miratimin dhe ndryshimin e akteve nënligjore	18
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	8
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së	9
Vendime në tërësi	172

Po kështu Bordi i AMF ka dhënë miratime për ndryshime statutorë të shoqërive të sigurimit, të shoqërive administruese të fondeve të pensionit, miratime të ndryshimeve të prospekteve, ndryshimeve të kontratave tip në fondet e pensioneve private vullnetare, kontratave të sigurimit, miratim të ofertës private të obligacioneve në tregun e letrave me vlerë, etj.

Vendimet të tjera të rëndësishme lidhen me funksionet mbikëqyrëse dhe përshijnë masa korigjuese dhe sanksione, që kanë synuar parandalimin e situatave jo të përshtatshme, si dhe eliminimin e shkeljeve.



Enkeleda Shehi
Kryetare

Kompetencat kryesore të Bordit të AMF-së

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie;
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së institucionit;
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj;
4. Shpërmdan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore;
5. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiar jo-bankar;
6. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë;



Mati Pepa
Nënkryetar



Enkela Idrizi
Nënkryetare

Shënim: ² Në këtë grup vendimesh, ndër më kryesoret, përfshihen ato për ndryshim statuti të shoqërive, licencime, ndryshime në kontratat e sigurimit dhe fondeve të pensioneve private vullnetare, ndryshim Prospekti, vendime për veprimtarinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, etj.



Miranda Ramaj
Anëtare



Riçard Marku
Anëtar



Kestrin Katro
Anëtare




Astrit Hado
Anëtar

7. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët;
8. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit;
9. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit;
10. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jo-bankar;
11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jo-bankare;
12. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e tregut financiar jo-bankar;
13. Miraton manualët e inspektimit;
14. Merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin;
15. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-së;
16. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit;
17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës;
18. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të AMF-së;
19. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e punonjësve.

Struktura organizative e AMF-së

AMF funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Vendim nr. 98, datë 30.04.2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, me propozim të Bordit të Autoritetit dhe ka 58 punonjës. Në fund të vitit 2012, shkalla e plotësimit të vendeve të punës në AMF, e matur me numrin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar dhe për të cilat janë




punësuar punonjësit, ka arritur në 84%. Rritja e shkallës së plotësimit të vendeve të punës ka ndihmuar në përballimin më cilësor të vëllimit gjithnjë në rritje të aktivitetit të AMF-së në përmbushje të objektivave.

78% e numrit të punonjësve të AMF-së i përkasin njësive që kryejnë funksione kryesore, të cilat lidhen me detyrat bazë të AMF-së, të tilla si licencimi, rregullimi e mbikëqyrja. Në këtë grup janë përfshirë edhe të emëruarit në nivelin e lartë drejtues. Pjesa tjetër, rreth 22% janë punonjës të angazhuar në funksionet mbështetëse, që mundësojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit.




Ekipi drejtues i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Grafik 1: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore të AMF-së sipas njësive (në %)





Grafik 2: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas profesionit (në %)




Mosha mesatare e të gjithë punonjësve të AMF-së është 39 vjeç dhe prej disa vitesh është ruajtur pothuajse i njëjti nivel. Kufinjte brenda të cilëve luhatet mosha e punonjësve të AMF-së sigurojnë ndërthurjen më të mirë të dinamizmit që sjellin punonjësit me moshë të re në punë, me njohuritë profesionale dhe aftësitë jetësore që zotërojnë punonjësit me përvojë. Kombinimi i këtyre dy elementëve rrit efektivitetin në punë dhe mundëson përballimin me sukses të detyrave komplekse. AMF ka ruajtur raporte optimale në strukturën e punonjësve bazuar edhe në arsimimin e tyre. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar punësimit të të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Grafik 3: Struktura e punonjëve të AMF-së sipas grupmoshës (në numër)





Grafik 4: Struktura e stafit teknik sipas diplomimit (në %)



Zhvillimet e sotme të tregjeve që AMF mbikëqyr kanë shtruar nevojën për një strukturë organizative më elastike, e cila do t'i shërbejë si mbulimit më të mirë të funksioneve mbikëqyrëse e rregullatore, ashtu edhe shtrirjes së këtyre funksioneve në aspekte të tjera. Një strukturë e tillë, do t'i paraprijë zhvillimeve të tregjeve, si dhe kapaciteteve që AMF duhet të zhvillojë në kuadër të planit të veprimit për administrimin e krizave. Kjo është theksuar edhe nga rekomandimet e organizmave ndërkombëtar si Banka Botërore (BB) dhe Komisioni Evropian (KE).

Politikat e Burimeve Njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore në AMF konsiderohet si një funksion i rëndësishëm, pasi nëpërmjet tij rritet rendimenti dhe cilësia e punës si edhe sigurohen marrëdhënie optimale punëdhënës-punëmarrës. Në planin afatshkurtër, vëmendja e sektorit të burimeve njerëzore u përqendrua në:

- Nxitjen dhe motivimin e punonjësve;
- Trajnimin në vijimësi të punonjësve;
- Punësimin e burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore.

Gjatë vitit 2012 numri i të punësuarve në Autoritet u shtua me 2 punonjës. Përzgjedhja e punonjësve është kryer nëpërmjet procedurave të rekrutimit, të cilat lejojnë një përzgjedhje të mirë të kandidatëve që zotërojnë njohuri dhe aftësi shumë të mira profesionale dhe etikë e integritet të lartë në punë. AMF miratoi gjatë këtij viti edhe udhëzimin “Për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve në punë të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i cili ka për qëllim rritjen e përgjegjësisë individuale të punonjësve në kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e objektivave të institucionit si edhe rritjen e objektivitetit në vlerësimin e punës së punonjësve. Gjithashtu, gjatë vitit 2012, u ripërpunuan përskrimet e punës së

punonjësve për t'ju përshtatur në mënyrë sa më cilësore detyrave në rritje në funksionet mbikëqyrëse e rregullatore të AMF-së.

Kualifikimi profesional

Në përmbushje të rekomandimit për forcimin e kapaciteteve administrative, AMF, gjatë vitit 2012, ka patur në vëmendje hartimin e programeve të kualifikimit të punonjësve mbështetur në dy nivele:

- Trajnimin bazë për punonjësit e punësuar rishtazi në institucion;
- Kualifikimin profesional për pjesën tjetër të punonjësve.


Programi i trajnimeve është ndërtuar në përshtatje me objektivat e institucionit dhe ato individuale për punonjësit. Aktivitetet e realizuara për vitin 2012, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, kanë konsistuar në pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, takime, si dhe vizita në shkëmbimin e përvojave më të mira profesionale, mbështetur në asistencën e institucioneve ndërkombëtare në fushën financiare si: BB, KE, USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri, Qendra e Ndërkombëtare e Trajnimit e Maltës (MITC), si edhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve si Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO), Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS), Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve e SHBA-së (NAIC), etj. Gjatë vitit 2012, në këto aktivitete kanë marrë pjesë rreth 72% e punonjësve të funksioneve kryesore të AMF-së.

AMF në bashkëpunim me MITC organizuan për punonjësit e Departamentit të Mbikëqyrjes e Disiplinimit dhe Departamentit të Çështjeve Juridike trajnime në fusha specifike që lidheshin me produktet e sigurimit të Jetës dhe kontratave për to, infrastrukturën ligjore, mbrojtjen e konsumatorit. Trajnimi lidhur me "Praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare në mbrojtjen e konsumatorit" u zhvillua për herë të parë me pjesëmarrjen e një numri të madh punonjësish të AMF-së duke sjellë edhe më shumë informacion si në aspektin teorik ashtu edhe me përvoja konkrete të krahasueshme me tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.



Trajnimi për sigurimin e Jetës organizuar në bashkëpunim me MITC

Edhe gjatë vitit 2012 Autoriteti ka vazhduar të ofrojë për punonjësit programin e trajnimit on line "FSI Connect". Ky është viti dytë që AMF përdor këtë alternativë të re trajnimi, e cila shfrytëzohet edhe nga mjaft punonjës të autoriteteve mbikëqyrëse në botë. AMF, për punonjësit e saj, është abonuar për 5 pozicione përdoruesish on line të programit. Nëpërmjet këtij programi trajnimi, synohet dhënia e njohurive të reja dhe thellimi më tej i tyre për të gjitha nivelet e punonjësve në AMF në drejtim të mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve.



Në vazhdimësi të politikës për rritjen e kualifikimit profesional të punonjësve, AMF në fund të vitit 2012, mundësoi financimin për trajnimin e specialistëve të financës në programin kompjuterik "Financa 05". Gjithashtu, AMF, edhe gjatë vitit 2012, ka vazhduar nxitjen e kualifikimit të punonjësve edhe nëpërmjet financimit tërësor ose pjesor të specializimeve të profilizuara veçanërisht në drejtime që lejojnë realizimin me sukses të detyrave dhe objektivave të institucionit.

Tematikat kryesore të trajnimeve gjatë vitit 2012

- Mbrojtja e konsumatorit në tregun e sigurimeve;
- Mbikëqyrja e grupit në fushën e sigurimeve;
- Parimet kryesore në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve;
- Mbikëqyrja me fokus riskun;
- Sigurimi i avancuar i Jetës me theks në aspektet e kontabilitetit për kontratat e Jetës;
- Mbikëqyrja në tregun e pensioneve private;
- Mbikëqyrja dhe auditimi në tregun e letrave me vlerë;
- Legjislacioni BE në fushën e shërbimeve financiare;
- Praktika dhe infrastruktura ligjore në kuadrin e mbikëqyrjes së sigurimeve.

Auditimi i Brendshëm

Në vitin 2012, Njësia e Auditimit të Brendshëm është angazhuar në auditimin e 7 objekteve, që përfaqësojnë 100% të detyrave të planifikuara. Funkcioni i auditimit të brendshëm vijon të kryhet nga një specialist auditimi, me një përvojë pune 6-vjeçare pranë AMF-së dhe i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm të sektorit publik. Në bazë të gjetjeve të auditimeve të kryera, gjatë vitit 2012, janë dhënë 32 rekomandime, të cilat u janë raportuar njësisive të audituara si dhe Bordit të AMF-së.

Arkiv - Protokollit

Gjatë vitit 2012, korrespondenca zyrtare e AMF-së, e cila trajtohet në zyrën e Arkiv-Protokollit, përbëhet nga 3,469 praktika. Në Autoritet kanë ardhur 2,305 praktika nga institucionet e ndryshme shtetërore e private dhe si përgjigje nga palët e interesit. Nga praktikat e dala nga AMF drejt të tretëve, pjesa më e madhe e tyre, mbi 63%, janë dokumentacione fillestare që AMF i ka nxjerrë në drejtim të palëve të interesit, ndërsa pjesa tjetër është informacion si përgjigje që AMF i ka dërguar institucione të ndryshme. Korrespondenca e brendshme në AMF përmban 681 komunikime.

1.3 Buxheti

Përcaktimi i buxhetit të AMF-së bazohet në dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht në Ligjin nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes financiare”. AMF gjatë vitit 2012, si institucion i pavarur, ka siguruar financim tërësor nga burimet e veta.

Të ardhurat gjithsej të AMF-së për vitin 2012 janë realizuar në masën 142.93 milionë lekë ose 12.99% më shumë se viti 2011. Pothuajse të gjitha të ardhurat e realizuara janë nga veprimtaria e vitit (nga kontributet) në masën 142.46 milionë lekë. Një pjesë fare e vogël ka ardhur nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve vullnetare dhe nga të ardhurat e tjera (gjobat dhe interesat bankare).


Kontributi kryesor brenda grupit të të ardhurave të veprimtarisë i përket të ardhurave të përftuara nga kontributet e paguara prej subjekteve të tregut të sigurimeve, të cilat përbëjnë 95% të të ardhurave gjithsej. Niveli i realizimit të të ardhurave nga këto kontribute është rreth 10% më shumë se viti 2011.

Tabelë 2: Të ardhura

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera në lekë</i>
1. Të ardhura nga veprimtaria:	
1.1 Të ardhura nga tregu i sigurimit	135,235,828
1.1.1 Të ardhura nga kontributet e shoqërive të sigurimit	133,585,828
1.1.2 Të ardhura nga licencime në tregun e sigurimit	1,650,000
1.2 Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondet e investimeve	7,230,218
1.3 Të ardhura nga shoqëritë admin. të fondeve të pensioneve private	240,076
2. Të ardhura nga gjobat dhe interesat bankare	227,498
Totali	142,933,620

Tabelë 3: Shpenzime

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera në lekë</i>
1. Shpenzime funksionimi:	113,166,023
1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore	65,066,787
1.2 Shpenzime operative	48,099,236
2. Shpenzime financiare (rivlerësim valute me kursin e 31.12.2012)	430,639
3. Fonde të regjistruar për periudhat e ardhshme	29,336,958
Totali	142,933,620



Të ardhurat e AMF-së kanë dy përdorime kryesore:

- Financimin e shpenzimeve të funksionimit;
- Financimin e investimeve.

Gjatë vitit 2012, AMF ka kryer investime për blerje aktivesh dhe inventar ekonomik në vlerën 2.94 milionë lekë. Shpenzimet për investime janë orientuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike dhe mirëmbajtjes me synim rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes së AMF-së në tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës të punonjësve.

Të ardhurat e përdorura gjithsej, në vitin 2012, ishin 116.54 milionë lekë ose 14.40% më shumë se në viti 2011.

Shpenzimet e funksionimit përbëjnë përdorimin kryesor të të ardhurave të AMF-së, duke zënë 97.10% të shpenzimeve gjithsej. Për vitin 2012, ato janë realizuar në masën 113.16 milionë lekë ose 13.50% më shumë se viti 2011. Shpenzimet për investime në vitin 2012 janë realizuar në masën 2.94 milionë lekë ose 34% më pak se viti 2011.

Në zbatim të planit të investimeve, AMF ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2012, përmbante 3 procedura prokurimi, nga të cilat janë realizuar 2, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar me prokurime me vlera të vogla.

Duke nisur nga viti 2007 e në vazhdim, pasqyrat financiare vjetore të AMF-së auditohen nga ekspertë kontabël të autorizuar, pavarësisht se një gjë e tillë nuk buron nga detyrime ligjore. Raportet e dorëzuara nga ekspertët kontabël në përgjithësi vlerësojnë se “Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të AMF-së si edhe performacën financiare”.



Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme

1.4 Ndryshime në kuadrin rregullues të AMF-së

Gjatë vitit 2012, AMF ka punuar për ndryshimin e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Oëllimi i këtyre ndryshimeve konsiston në forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së, në përmbushje të objektivave të tij. Këto synime arrihen nëpërmjet ritheksimit të pavarësisë de jure, ndërthurjes më të mirë me përgjegjshmërinë, si dhe të përfshirjes në ligj të dispozitave që krijojnë mekanizma mbrojtës për pavarësinë e Autoritetit në të ardhmen. Përgatitja e projektligjit me ndryshimet

përkatëse është bërë në bashkëpunim me grupin e ekspertëve, juristë nga SHBA, Franca dhe Polonia të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC). Në hartimin e tij janë mbajtur parasysh edhe rekomandimet dhe komentet e paraqitura në vite nga BB në Aide Memoire³, KE, në Raportet Vjetore të Progresit të përgatitura për Shqipërinë⁴, si edhe FMN⁵.

Gjatë vitit 2012, Bordi i AMF-së ka miratuar një sërë rregulloresh të reja dhe ndryshimesh në ato ekzistueset që janë të lidhura me funksionimin institucional të AMF-së. Ndër më të rëndësishmet veçojmë:

Rregulloren nr. 90, datë 18.07.2012 **“Për rregullat e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve në zotërim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”**, me qëllim forcimin e kontroleve për evidentimin, ruajtjen dhe miradministrimin e aktiveve në zotërim të AMF-së.

Udhëzimin nr. 117, datë 29.08.2012, **“Për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve në punë të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”** i cili ka si qëllim përcaktimin e procedurave dhe rregullave për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve të punës së punonjësve të AMF-së.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në Rregulloren ekzistuese nr. 177, datë 13.12.2011, **“Mbi organizimin e veprimtarisë kërkimore në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”**, të miratuara me vendim Bordi nr. 98, datë 18.07.2012. Këto ndryshime kanë si qëllim përcaktimin e mënyrës së thirrjes së Bordit Kërkimor, procedurën e zhvillimit të mbledhjes dhe marrjes së vendimit.

Shënim: ³ BB (10 janar 2007), “Albania Post FSAP NBFi Integration and Insurance Sector Supervision Technical Assistance Mission for FSA 3-15 December 2006 - Aide-Mémoire”; (10 maj 2007), “Albania FSAP NBFi Integration and Insurance Sector Supervision Technical Assistance Aide-Mémoire of FSA 16-21 April, 2007 Mission”; (8 mars 2011), “Aide-Mémoire of Insurance Technical Mission, November 22-26, 2010”.
⁴ KE, “Albania Progress Report” 2010, 2011, 2012, Chapter 9: Financial Services, Brussels.
⁵ FMN (2010), “Detailed assessment report on anti-money laundering and combating the financing of terrorism”

Kapitulli 2 Aktiviteti i AMF



2.1 Aktiviteti rregullator

Gjatë vitit 2012, në kuadër të përmirësimit të akteve ligjore ekzistuese dhe përafrimit të tyre me direktivat e Bashkimit Evropian, BE, Autoriteti hartoi 6 akte të reja nënligjore dhe realizoi ndryshime në disa rregullore ekzistuese për tregjet nën mbikëqyrje. Këto akte kanë synuar edhe mbështetjen e objektivit të AMF-së për kalimin drejt mbikëqyrjes me fokus rrisht. Po kështu u punua për përfshirjen e rekomandimeve të institucioneve përkatëse dhe palëve të interesit në projektligjin **“Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”**. Drafti i parë i këtij projektligji përfundoi në dhjetor të vitit 2011. Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2012, ky projektligj u rishikua sërish më qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Aktet nënligjore në fushën e sigurimeve

Aktet e reja nënligjore në fushën e sigurimeve janë:

Rregullore nr. 36, datë 21.03.2012 **“Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”**, e cila përcakton rregulla në lidhje me krijimin, llogaritjen, financimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit.

Rregullore nr. 126, datë 05.09.2012 **“Për procedurat e ndalimit të përdorimit të lirë të pasurive të shoqërisë së sigurimit”**, e cila ka si objekt përcaktimin e procedurave për ndalimin e përdorimit të lirë të pasurive të shoqërisë së sigurimit, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, nënshkruesve apo përfituesve të kontratave të sigurimit.

Udhëzim nr. 140, datë 26.09.2012 **“Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit”**, i cili zbatohet së bashku me kërkesat e Rregullores “Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg”, miratuar me vendim Bordi nr. 26, datë 23.02.2011, dhe ka si qëllim përcaktimin e listës së dokumenteve që përbëjnë llogaridhënien e detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit, të cilat raportohen në AMF nëpërmjet sistemit AMF In-Reg.

Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshime në rregulloret ekzistuese si më poshtë:

Rregullore nr. 26, datë 23.02.2011 **“Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg”**, ndryshuar me vendim Bordi nr. 141, datë 26.09.2012. Ky ndryshim ka të bëjë me rregullimin e procedurave të punës në sistemin AMF In-Reg, ku është shtuar firma elektronike.



Departamenti i Çështjeve Juridike

Rregullore nr. 9, datë 08.02.2007 **“Mbi bazat, metodat e llogaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetës”**, ndryshuar me vendim Bordi nr. 61, datë 25.04.2012. Ky ndryshim konsiston në përcaktimin e mënyrës që duhet të përdorin aktuarët e shoqërive për llogaritjen e provigjoneve teknike të dëmeve në procese gjyqësore.

Rregullore nr. 110, datë 28.07.2011 **“Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”**, ndryshuar me vendim Bordi nr. 142, datë 29.10.2012. Ndryshimet konsistojnë në rishikimin e afatit minimal për ndryshimin e primit të sigurimit nga “6 (gjashtë)” në “3 (tre)” muaj. Rishikimi i këtij afati është bërë për të qenë në një linjë me parashikimet ligjore për afatin e llogaritjes së provigjoneve teknike.

Ndryshime në Udhëzimin nr. 2, datë 21.11.2007 **“Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare nën mbikëqyrje”**, të miratuara me vendim Bordi nr. 161, datë 21.12.2012. Këto ndryshime konsistojnë në rregullimin e mëtejshëm të procedurës dhe afateve për verifikimin e informacionit të marrë gjatë inspektimit me qëllim arritjen e konkluzioneve sa më të drejta. Ky udhëzim gjen zbatim edhe në tregjet e tjera nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Aktet nënligjore në fushën e letrave me vlerë

Aktet e reja nënligjore në fushën e letrave me vlerë përfshijnë:


Rregullore nr. 160, datë 21.11.2012 **“Për kushtet e organizimit dhe funksionimit të platformës shumëpalëshe të tregtimit-MTF”**, e cila ka si qëllim përcaktimin e kushteve për organizimin dhe funksionimin e Platformës Shumëpalëshe të Tregtimit (MTF), si dhe kushtet që duhet të plotësojnë operatorët për të vënë në funksionim këtë platformë.

Rregullore nr. 50, datë 21.03.2012 **“Mbi rrethanat e veçanta për pagesën në tituj të kuotave të fondit të investimit”**, e cila ka si qëllim përcaktimin e rrethanave të veçanta për pagesën në tituj të kuotave të fondit të investimit, si dhe procedurën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Gjithashtu, janë bërë ndryshime në Rregulloren nr. 120, datë 02.10.2008 **“Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e Bursës së Titujve”**, të miratuar me vendim Bordi nr. 153, datë 21.11.2012. Këto ndryshime konsistojnë në shtimin e funksioneve të një shoqërie që operon si bursë titujsh duke i dhënë asaj edhe të drejtën për të vënë në funksion një platformë tregtimi shumëpalëshe (MTF) si dhe janë shtuar subjekte që mund të kenë të drejta pronësie në një bursë titujsh.

Aktet nënligjore në fushën e pensioneve private vullnetare

Aktet e reja nënligjore dhe ndryshimet në ato ekzistuese për tregun e pensioneve private vullnetare përfshijnë:



Rregullore nr. 139, datë 26.09.2012 "**Për përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit vullnetar dhe afatet e publikimit të informacionit**", e cila ka si qëllim të përcaktojë mënyrën e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve të fondit të pensionit, përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit dhe vlerës së kuotës së fondit të pensionit si dhe shpeshhtësinë e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit.

Ndryshime në Rregulloren nr. 1, datë 28.01.2010 "**Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit**". Këto ndryshime janë miratuar me vendim Bordi nr. 32, datë 21.03.2012 dhe që konsistojnë në heqjen e kufizimit të afatit të maturimit të depozitave me qëllim përfaqshjen e legjislacionit me praktikën më të mira të vendeve të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik e Zhvillim (OECD).

2.2 Aktiviteti licencues

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta në procesin licencues, AMF është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e licencimit të zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në tregun financiar nën mbikëqyrje, të jenë të qarta, objektive dhe transparente, duke e vënë theksin në:

- Gjendjen e shëndoshë financiare të aplikantit;
- Aftësitë profesionale dhe të besueshmërisë të drejtuesve dhe vendimmarrësve të aplikantit;
- Hartimin e strukturave të përshtatshme të mënyrës së qeverisjes së aplikantit;
- Paraqitjen e planeve financiare dhe të biznesit në mënyrë sa më të qartë dhe të argumentuar.

Aktiviteti licencues në sigurime

Risia e këtij viti, në aspektin licencues, ka qenë miratimi i licencës për shoqërinë "ANSIG" sh.a., në datë 22 qershor 2012. Kjo shoqëri u miratua për ushtrimin e veprimtarisë në tregun e sigurimeve, për klasat e Jo-Jetës.

Licencimi i shoqërisë "ANSIG" sh.a. vjen pas një shqyrtimi të kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave të ndërmarra nga shoqëria, në përputhje me kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi. Ky licencim kaloi në dy faza. Në nëntor të 2011, Bordi i AMF-së miratoi licencimin paraprak të kësaj shoqërie, e cila lidhej më përmbushjen e kërkesave të nevojshme për ndërtimin e biznesit në tregun e sigurimeve.



Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit

LICENCAT QË LËSHON AUTORITETI

- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri sigurimi;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri risigurimi;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë së huaj të sigurimit;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si broker në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri brokerimi në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime;
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si aktuar i autorizuar;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si konsulent në sigurime;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri administruese;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si depozitar;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si agjent i fondit të pensionit;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri agjentësh të fondit të pensionit;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si degë e shoqërisë administruese;
- Licencë për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri investimi kolektive me ofertë publike;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si shoqëri brokerimi në tituj;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si broker në tituj/komisioner burse;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si këshilltar investimesh;
- Autorizim për ushtrimin e veprimtarisë si kujdestar i autorizuar;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si bursë titujsh;
- Licencë për ushtrim veprimtarie si regjistrar.

është gjithnjë në interes të konsumatorit, por jo vetëm kaq, për AMF, një treg konkurrent me një numër në rritje të operatorëve, do të thotë më tepër hapësirë dhe fleksibilitet për ushtrimin e mekanizmave mbikëqyrëse dhe kjo ndikon drejtpërdrejtë në favor të mbrojtjes së konsumatorit. Dinamika e zhvillimeve të tregut të sigurimeve, si segment i tregut financiar, e ka bërë këtë treg të jetë vazhdimisht në fokusin e investitorëve strategjikë.


Dhënia në sipërmarrje e disa funksioneve të shoqërisë së sigurimit

Për herë të parë në vitin 2012, AMF miratoi kërkesën e shoqërive të sigurimit "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a., "Interalbanian Vienna Insurance Group" sh.a. dhe "Intersig Vienna Insurance Group" sh.a., të gjitha shoqëri të kontrolluara nga shoqëria Vienna Insurance Group, për dhënien në sipërmarrje të disa funksioneve tek një shoqëri e emërtuar "VIG Services Shqipëri" sh.p.k. Kështu, në muajin shkurt, u miratua dhënia në sipërmarrje e funksionit të mbajtjes së kontabilitetit dhe të informatizimit, ndërsa në maj u miratua edhe funksioni i trajtimit të dëmeve. Dhënia në sipërmarrje e këtyre funksioneve nuk cenon përgjegjësinë e secilës shoqëri sigurimi në lidhje me funksionin që jepet në sipërmarrje, si dhe detyrimin për raportim.

Në fazën e dytë, që u përmbyll me dhënien e licencës në qershor 2012, shoqëria përmbushi detyrimet lidhur me krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë, përzgjedhjen e ekipit drejtues, derdhjen e shumës së kapitalit fillestar dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për fillimin e aktivitetit. AMF i ka vlerësuar me kujdes të gjithë këta elementë, duke i kushtuar kujdes të veçantë edhe profesionalizmit të ekipit drejtues. Futja e një operatori të ri në tregun e sigurimeve është një sinjal tepër pozitiv. Ky sinjal duhet të interpretohet në disa drejtime.

Së pari, konfirmon zhvillimin e vazhdueshëm të tregut dhe faktin që tregu i sigurimeve është tërheqës për investitorë të rinj. Tregut të sigurimeve i injektohen menjëherë edhe 370 milionë lekë kapitale, që do të thotë kapacitet shtesë për nënshkrimin e risqeve në tregun vendas.

Së dyti, futja e operatorit të ri do të rrisë më tepër presionin ndaj tregut për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit. Konkurrenca cilësore



Licencimi i profesionistëve në sigurime

Gjithashtu, gjatë vitit 2012, aktiviteti licencues i AMF-së ka vazhduar në drejtim:

- Të licencimit të ndërmjetësve në sigurime: broker dhe agjentë;
- Të licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime;
- Të autorizimit të aktuarëve në sigurime.

Broker në sigurime

Gjatë vitit 2012, numri i shoqërive të brokerimit në sigurime pati ndryshime. Kështu, gjatë vitit u licencuan dy shoqëri të reja brokerimi: shoqëria “Smart Brokers” sh.a. dhe “WVP-Ndërmjetësim në sigurime” sh.a., si edhe u tërhoq licenca për shoqërinë “Bindi Insurance Broker” sh.a., me kërkesë të vetë asaj. Ndërkohë, shoqëria e brokerimit “P&C Albania” sh.a. ndryshoi emërtim në shoqëria “3BBroker” sh.a. Si rrjedhim, në fund të vitit 2012, tregu i sigurimeve numëroi 7 shoqëri brokerimi, nga të cilat 5 ushtrojnë veprimtari në klasat e Jo-Jetës dhe 2 në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës.

Në fund të vitit 2012, numri i brokerave fizikë të licencuar nga AMF arriti në 10. Tabela më poshtë jep të dhëna të detajuara për licencimin e brokerave sipas statusit të tyre.

Tabelë 4: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime

(në numër)

<i>Statusi i brokerit</i>	<i>Gjithsej të licencuar në fund të vitit 2011</i>	<i>Brokera të licencuar/ rilicencuar në vitin 2012</i>	<i>Përfunduar afati i licencës në vitin 2012</i>	<i>Tërheqje licence gjatë vitit 2012</i>	<i>Gjithsej të licencuar në fund të vitit 2012</i>
Persona juridikë	6	2	-	1	7
Persona fizikë	9	5	2	2	10

Veprimtaria e shoqërive të brokerimit konsiston në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit si: Shëndeti në Udhëtim, Garanci Oferte dhe Kontrate, Kasko, TPL, Karton Jeshil, Sigurimi Kufitar, Sigurimi i karburanteve, Sigurimi nga zjari, Sigurimi CAR dhe Sigurimi i Jetës “Sot për nesër”.

Agjentë në sigurime

Shitja e policave të sigurimit nga shoqëritë e sigurimit realizohet nëpërmjet punonjësve shitës apo agjentëve të licencuar. AMF ka siguruar informacionin e plotë mbi çdo punonjës shitës, si dhe ka kërkuar plotësimin e kriterëve nga çdo subjekt që kërkon të licencohet si agjent shitës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit.

Në fund të vitit 2012, shoqëritë e licencuara për të vepruar si agjent në sigurime janë: shoqëria “UDSA” sh.p.k., shoqëria “Posta shqiptare” sh.a. dhe shoqëria “NOA” sh.a., ndërsa numri i përgjithshëm i agjentëve fizikë të licencuar arriti në 279.

Pjesa më e madhe e agjentëve fizikë gjatë vitit 2012 janë licencuar apo u është rinovuar licenca për llogari të shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a. dhe shoqërisë “Insig” sh.a. Shoqëria “UDSA” sh.p.k. dhe agjentët e saj fizikë veprojnë si ndërmjetës për llogari të 6 shoqërive të sigurimit: “Insig” sh.a., “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., “Atlantik” sh.a., “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a., “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a. dhe “Eurosig” sh.a. Shoqëria “Posta shqiptare” sh.a. dhe agjentët e saj fizikë veprojnë si ndërmjetës për shoqërinë e sigurimit “Insig” sh.a. Shoqëria “NOA” sh.a. dhe agjenti i saj veprojnë si ndërmjetës për shoqërinë e sigurimit “Sigal-Life Uniqa Group Austria” sh.a.

Tabelë 5: Të dhëna mbi agjentë të licencuar (në numër)


<i>Statusi i agjentit</i>	<i>Gjithsej të licencuar në fund të vitit 2011</i>	<i>Agjentë të rilicencuar në vitin 2012</i>	<i>Agjentë të rinj të licencuar në vitin 2012</i>	<i>Përfunduar afati i licencës në vitin 2012</i>	<i>Gjithsej të licencuar në fund të vitit 2012</i>
Persona juridikë	4	1	1	3	3
Persona fizikë	237	23	85	66	279

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Për t'i shërbyer procesit të vlerësimit të dëmeve në sigurime prej vlerësuesve të licencuar, AMF gjatë vitit 2012 licencoi 10 vlerësues të tjerë, duke e çuar në 65 numrin e përgjithshëm të vlerësuesve me licencë. Tabela më poshtë pasqyron të dhënat mbi vlerësuesit e licencuar të ndarë sipas llojit të licencës dhe sipas statusit të tyre.

Tabelë 6: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar (në numër)

<i>Vlerësues dëmsh në sigurime</i>	<i>Në fund të vitit 2011</i>	<i>Licencime të reja 2012</i>	<i>Tërheqje licence 2012</i>	<i>Gjithsej në fund të 2012</i>	
1. Sipas statusit të vlerësuesit	I pavarur	17	4	-	21
	I punësuar	38	6	-	44
2. Sipas llojit të licencës	Për dëme materiale	5	-	-	5
	Për dëme shëndetësore	4	1	-	5
	Për dëme materiale dhe shëndetësore	46	9	-	55
Gjithsej vlerësues të licencuar	55	10		65	



Gjatë vitit 2012, vëmendje iu kushtua mbikëqyrjes së veprimtarisë së vlerësuesve të pavarur. Për këtë qëllim, në mars të 2012, me vendim të Bordit, u miratuan formularët mbi raportimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, nëpërmjet të cilëve AMF vihet në dijeni mbi veprimtarinë e vlerësuesve të pavarur të dëmeve, si subjekte që përfaqësojnë të dëmtuarin në proceset gjyqësore.

Aktuar në sigurime

Roli i aktuarit në shoqërinë e sigurimit është thelbësor në hartimin e raporteve aktuariale, llogaritjen e provigjoneve të sigurimeve dhe llogaritjen e marzhit të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit. Gjatë vitit 2012, AMF autorizoi 2 aktuarë të tjerë në sigurime duke e çuar në 15 numrin total të tyre.

Testi profesional për profesionet në fushën e sigurimeve

Aktet nënligjore mbi përcaktimin e kriterëve të licencimit të profesioneve në fushën e sigurimeve, si profesioni i brokerit në sigurime, profesioni i vlerësuesit të dëmeve, apo profesioni i aktuarit, kanë përcaktuar si kusht licencimi edhe kalimin me sukses të testimit për njohuritë në fushën përkatëse.


Gjatë vitit 2012, Autoriteti ka organizuar rregullisht testime në përputhje me kërkesat e paraqitura nga aplikantët të ndryshëm për t'u pajisur me licenca përkatëse. Kështu, janë organizuar 3 testime për aplikantët që kërkuan të pajisen me licencë "vlerësues dëmsh në sigurime" dhe 3 testime për pajisje me licence "broker në sigurime". Qëllimi i organizimit të testimeve ka qenë vënia e theksit tek profesionalizmi i aplikantëve që kërkojnë të licencohen, me synimin kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të veprojnë. Në përbërje të komisioneve të testimit është synuar të jenë përfaqësues me reputacion dhe përvojë si nga rrethi akademik, ashtu edhe nga tregu.

Prania e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit

Gjatë vitit 2012, në tregun shqiptar të sigurimeve nuk pati ndryshime në numrin e aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit dhe aktualisht në tregun shqiptar të sigurimeve operojnë:

- Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe me seli qendrore në Vienë, Austri;
- Uniqa International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH me seli qendrore në Vienë, Austri;
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve.

Grafik 5: Struktura e kapitalit sipas vendit të originës - 2012





Qeverisja e shoqërive të sigurimit

Në funksion të mirë-qeverisjes së shoqërive të sigurimit, AMF ka synuar rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit të të zgjedhurve në këshillat mbikëqyrëse, në postet drejtuese apo komitetet e kontrollit në këto shoqëri.

Gjatë vitit 2012, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo rime të reja në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në tri shoqëri sigurimi, si dhe ka miratuar emërimet në organet drejtuese në katër shoqëri sigurimi. AMF gjithashtu ka miratuar edhe drejtuesin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

Grafik 6: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të sigurimit






Tabelë 7: Qeverisja e shoqërive të sigurimit – Statistika

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Nr. mesatar i aksionarëve	6.0	4.5	4.2	4.4	4.2	3.7
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës	5.0	3.6	3.4	3.6	4.0	4.2
Nr. mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë	2.0	2.8	2.7	3.1	3.5	3.7
Nr. i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10%	3.0	3.0	2.0	2.0	3.0	3.0

Tabelë 8: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit


Emërtimi	Numri
Shoqëri sigurimi	11
Aksionarë gjithsej	41
Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:	
nën 10%	21
mbi 10% nën 20%	6
mbi 20% nën 33%	1
mbi 33% nën 50%	3
mbi 50%	10
Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:	
Aksionarë të huaj	3
Aksionarë vendas	38
Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:	
Aksionarë individë	32
Aksionarë shoqëri	8
Aksionarë shteti	1

Grafik 7: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese (në %)



Grafik 8: Të dhëna për aksionarët sipas vendit të origjinës dhe statusit

(në %)

**Miratime të ndryshimeve staturore të shoqërive të sigurimit**

Gjatë vitit 2012, Autoriteti ka miratuar një numër kërkesash për ndryshime staturore, të cilat kanë konsistuar në:

- Statute të reja, përshtatje me ndryshimet ligjore apo të neneve të statutit për 6 shoqëri sigurimi;
- Ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të madhësisë së kapitalit aksionar për 4 shoqëri sigurimi;
- Ndryshimin e statutit si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare për 2 shoqëri sigurimi.


Tabelë 9: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve staturore

(në numër shoqëri)

Arsyeja e ndryshimit të statutit	2008	2009	2010	2011	2012
Statut i ri e ndryshime të tjera	2	2	2	6	6
Rritje kapitali	9	4	2	4	4
Ndryshim i strukturës aksionare	2	2	5	3	2

Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Në mbledhjen e datës 26.09.2012, Bordi i AMF-së miratoi licencimin e fondit të investimit "Raiffeisen Invest Euro" nën administrimin e shoqërisë "Raiffeisen INVEST-Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a. Licencimi i fondit të investimit "Raiffeisen Invest Euro" nënkupton miratimin e dokumenteve themelore të fondit siç janë prospekti dhe rregullat e tij. Fondi i ri i investimit, ndonëse nga pikëpamja e objektivit të investimit dhe instrumentet ku investohen asetet monetare ka ngjashmëri me Fondin Raiffeisen Prestigj, përfaqëson një alternativë të re investimi në



monedhë të huaj. Investitorët shqiptarë do të kenë mundësinë që të investojnë kursimet e tyre edhe në asete financiare kryesisht në euro.

Gjatë vitit 2012, tregut me pakicë të letrave me vlerë iu shtua edhe një operator i ri, shoqëria “Banka Societe Generale Albania” sh.a., e cila në mars 2012 u licencua për të ushtruar veprimtari brokerimi në këtë treg.

Në qershor të 2012, shoqëria “EASY Trade Consulting” sh.p.k. u miratua për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë “Forex Capital Market LTD”, krahas shoqërisë së brokerimit “AKSIONER International Securities Brokerage” sh.a., e cila vepron si agjent i shoqërisë “SAXO Bank”, duke filluar nga muaji janar 2012. Për të monitoruar veprimtarinë e këtyre shoqërive, në nëntor, Autoriteti miratoi formularin e raportimit për veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2012, aktiviteti licencues ka konsistuar në licencimin e një brokeri fizik në letrat me vlerë, në miratim administratori të shoqërisë së brokerimit apo shoqërisë administruese të fondeve, si dhe miratim të ndryshimeve të prospektit të Fondit të Investimeve Raiffeisen Prestigj.

Pjesa më aktive e tregut të letrave me vlerë është tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare. Në këtë treg operojnë kryesisht bankat, të licencuara nga AMF për të kryer këtë veprimtari. Bankat e licencuara janë: “Raiffeisen Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a., “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., “Alfa Bank Albania” sh.a., “Banka Credins” sh.a., “Tirana Bank” sh.a., “First Investment Bank” sh.a. dhe “Banka Societe Generale Albania” sh.a.

Tabela 10: Subjekteve të licencuara që operojnë në tregun e letrave me vlerë (në numër)

<i>Subjekte të licencuara</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>
Shoqëri komisionere të letrave me vlerë	12	13	13
Broker fizik në shoqëri komisionere	16	17	18
Kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.Sh.	7	8	8
Rregjistruar të letrave me vlerë	1	1	1
Tregje të organizuar të letrave me vlerë	1	1	1

Miratimi i ofertës private të obligacioneve

Në muajt shkurt, shtator dhe dhjetor 2012, AMF miratoi prospektet respektive të paraqitura nga emetuesi, shoqëria “Banka Credins” sh.a., për emetim obligacionesh me ofertë private.

Ofertë private e obligacioneve

Ofertë private e obligacioneve është emetimi, në të cilin oferta për të nënshkruar obligacione u drejtohet vetëm investitorëve institucionalë, aksionarëve ose punonjësve, por jo më shumë se 100 investitorëve të jashtëm, të cilët janë adresuar drejtpërdrejtë tek emetuesi.

Në rastin e një oferte private të obligacioneve, emetuesi komunikon me investitorët e mundshëm nëpërmjet dorëzimit të ofertës (prospektit) në adresën e investitorit. Prospekti, përpara dorëzimit të tij tek investitorët e mundshëm, paraqitet për miratim pranë AMF-së.

Aktiviteti licencues në tregun e pensioneve private vullnetare


Gjatë vitit 2012, numri i operatorëve të tregut të pensioneve private vullnetare nuk pati ndryshime. Në këtë treg operojnë 3 shoqëri administruese të fondeve të pensionit dhe 3 fonde të administruara respektivisht nga shoqëritë administruese.

Fokusi i AMF-së në tregun e pensioneve private vullnetare, në aspektin licencues, ka qenë miratimi i ndryshimeve të prospekteve, ndryshimeve të kontratave tip, apo ndryshime të tjera, të paraqitura si më poshtë:

- Ndryshimet e prospektit, si në rastin e Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen, të Fondit të Pensionit Vullnetar Sigal dhe Fondit të Pensionit Vullnetar SiCRED Pensions;
- Ndryshimet e kontratave-tip;
- Ndryshimin e strukturës aksionare dhe zmadhimit të kapitalit, për “Shoqërinë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life” sh.a.;
- Ndryshimin e depozitarit, për “Shoqërinë administruese të fondeve të pensionit SiCRED” sh.a.

2.3 Aktiviteti mbikëqyrës

Procesi i mbikëqyrjes mund të shihet si një cikël i cili fillon me monitorimin dhe analizimin e të dhënave financiare si edhe të dhënave të tjera të raportuara në AMF nga subjektet nën mbikëqyrje. Këto të dhëna përfshijnë edhe raportet e audituesve të pavarur dhe aktuarëve të autorizuar, si edhe informacionet nga të tretët. Informacioni i mbledhur analizohet dhe rezultatet e kësaj analize përdoren për të planifikuar inspektimet në vend si dhe për ndërhyrje kur është e nevojshme me masa të përcaktuara sipas ligjeve respektive. Cikli i mbikëqyrës kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas strategjisë dhe procedurave të hartuara nga AMF.



Mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, edhe gjatë vitit 2012, AMF ka realizuar mbikëqyrjen dhe analizimin e tregjeve respektive. Përsa i përket veprimtarisë në sektorin e sigurimeve, është shqyrtuar kryesisht pozicioni financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së tregut të sigurimeve dhe të shoqërive të sigurimit në veçanti. Si përparësi në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes kanë qenë përmirësimi i procesit të mbikëqyrjes së këtij tregu dhe ruajtja e interesave të të siguruarve.



Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit

Për një mbikëqyrje më efektive

Me përfundimin e projektit “Drejt një mbikëqyrje efektive” financiar nga First Initiative me asistencën e Bankës Botërore, projekt i cili kishte si objektiv forcimin e metodologjisë së mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, Autoriteti prezantoi Manualin e Mbikëqyrjes me Fokus Riskun.

Një sistem mbikëqyrjeje me fokus riskun, ka si qëllim hartimin e një profili risku për shoqërinë e sigurimit, i cili përfaqëson vlerësimin nga ana e autoritetit mbikëqyrës në lidhje me fushat e risqeve specifike të shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve. Përveç se është një sistem që identifikon dhe mat risqet, pjesë e këtij sistemi janë dhe fazat e ndërhyrjes nga ana e autoritetit mbikëqyrës, gjatë niveleve të ndryshme të riskut, ndërhyrje e cila shpeshtohet dhe forcohet me rritjen e nivelit të riskut në një shoqëri sigurimi.

Dy shtyllat kryesore të metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus riskun janë projektligji “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe sistemi i raportimit AMF In-Reg. Projektligji mbi sigurimet synon krijimin e hapësirave të nevojshme ligjore për zbatimin e kësaj metodologjie të re. Sistemi i raportimit AMF In-Reg është platforma dhe kanali kryesor i raportimit të subjekteve të mbikëqyrura në Autoritet. Në afatgjatë, ky sistem do të shërbejë si platforma kryesore mbështetëse e mbikëqyrjes me fokus riskun.

Në kuadrin e zbatimit gradual të metodologjisë së re të mbikëqyrjes, gjatë vitit 2012 është miratuar me vendim Bordi të AMF-së nr. 140 datë 26.09.2012 udhëzimi në lidhje me raportimin e detyruar periodik të shoqërive të sigurimit nëpërmjet sistemit AMF In-Reg.

Gjithashtu, AMF me ndihmën e një projekti të asistencës teknike të FSVC është duke punuar për ngritjen e arkitekturës së një sistemi të paralajmërimi të hershëm, i cili do të lehtësojë priorizimin dhe drejtimin e burimeve rregullatore drejt atyre siguruesve dhe aktiviteteve ku vëmendja rregullatore kërkohet më shumë.

Analiza Financiare e Tregut të Sigurimeve (off-site)

Analiza e thelluar financiare është kryer përmes vlerësimit të pozicionit financiar, rezultateve teknike dhe financiare të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit, mbështetur në të dhënat e raportimit periodik të këtyre shoqërive në AMF, informacioneve shtesë të depozituara nga këto shoqëri ose institucione të tjera, si dhe mbi gjetjet e inspektimit në vend.

Gjatë analizës së thelluar financiare, i kushtohet vëmendje e veçantë mbikëqyrjes së disa treguesve teknikë e financiarë të shoqërive të sigurimit. AMF vlerëson nëse provigjonet teknike, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj të siguarve, janë të mjaftueshme dhe mbulohen jo më pak se vlera bruto e tyre me aktive të përshtatshme në çdo kohë. Gjithashtu AMF, ndër të tjera, vlerëson treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të cilat në çdo kohë duhet të jenë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Mospërbushja e kërkesave të bazës ligjore për këta tregues, përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të riskut.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përbushjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë Fondin e Garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit. Totali i Fondit të Garancisë për tregun është në vlerën 4.75 miliardë lekë. Tregu i sigurimeve më 31.12.2012 ka qenë i mirëkapitalizuar, gjë që ilustron nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në masën 131.47%.

Tabelë 11: Struktura dhe dinamika e aktivitetit dhe pasivitetit të tregut të sigurimeve⁶

Emërtimi	31.12.2010	31.12.2011	31.12.2012
	<i>struktura (në %)</i>		
Depozita	50.84	45.90	41.38
Toka dhe ndërtime	10.23	9.32	9.56
Aksione dhe pjesëmarrje	9.31	13.65	12.90
Bono thesari	4.91	4.89	6.44
Debitorë	8.45	8.66	10.02
Aktive të tjera	16.27	17.58	19.70
Totali i Aktivitetit	100.00	100.00	100.00
Provigjonet teknike bruto	34.21	39.44	40.14
Detyrime të tjera	8.06	7.79	9.72
Kapitalet e veta	57.73	52.77	50.14
Totali i Pasivitetit	100.00	100.00	100.00

Shënim: ⁶ Pasqyrat e bilancit në këtë tabelë përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në mbështetje të bazës rregullative të AMF-së.



Emërtimi	31.12.2010	31.12.2011	31.12.2012
<i>dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100</i>			
Depozita	113.35	96.94	96.43
Toka dhe ndërtime	116.45	97.82	109.80
Aksione dhe pjesëmarrje	125.36	157.41	101.10
Bono thesari	181.14	107.04	140.90
Debitorë	111.61	110.03	123.82
Aktive të tjera	87.38	116.07	119.86
Totali i Aktivit	111.16	107.37	106.98
Provigjonet teknike bruto	99.07	123.76	108.89
Detyrime të tjera	100.15	103.76	133.42
Kapitalet e veta	121.85	98.16	101.65
Totali i Pasivit	111.16	107.37	106.98

Gjatë analizës së gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, për të dhënat më 31.12.2012 u vu re se:

Aktivitetet e tregut të sigurimeve krahasuar me vitin 2011 u rritën me 1.35 miliardë lekë ose 6.98%. Investimet në depozita në banka zënë pjesën më të madhe të aktivitetit me 41.38%, investimet në toka dhe ndërtesa përbëjnë 9.56% të totalit të aktivitetit. Rritja e aktivitetit të tregut reflektohet në rritjen e investimit në Bono Thesari, Aksione dhe Interesa Pjesëmarrëse, Aktive të tjera, si dhe në zërin Debitorë. Në pasivin e pasqyrës së Bilancit më 31.12.2012 vihet re rritja e zërit Provigjone Teknike Bruto në masën 8.89% ose në vlerën 679.25 milionë lekë në krahasim më 31.12.2011.

Tabelë 12: Disa të dhëna mbi tregun e sigurimeve

(në mln. lekë)

Periudha Ushtrimore	2008	2009	2010	2011	2012
Totali i aktiveve	15,525	16,227	18,039	19,368	20,720
Jeta	1,841	2,919	2,473	2,884	3,207
Jo-Jeta	13,684	13,308	15,566	16,484	17,513
Totali i investimeve	11,182	10,830	11,855	12,839	14,209
Jeta	1,389	2,101	1,832	1,992	1,996
Jo-Jeta	9,793	8,729	10,023	10,847	12,213
Provigjonet teknike bruto	5,138	6,229	6,171	7,638	8,317
Jeta	233	361	644	853	942
Jo-Jeta	4,905	5,868	5,527	6,785	7,375

Totali i kapitalit	8,832	8,546	10,413	10,221	10,389
Jeta	1,541	1,754	1,764	1,791	1,899
Jo-Jeta	7,291	6,792	8,649	8,430	8,490
Totali i kapitalit të nënshkruar	6,031	5,787	6,684	7.607	8,617
Jeta	1,248	1,097	1,278	1,283	1,284
Jo-Jeta	4,783	4,690	5,406	6,324	7,333
Totali i investimeve të huaja	2,924	1,985	3,587	3,472	3,597
Jeta	460	355	347	380	398
Jo-Jeta	2,463	1,630	3,240	3,092	3,199
Primi i fituar neto	5,543	6,092	6,680	6,792	6,736
Jeta	459	496	636	819	823
Jo-Jeta	5,084	5,596	6,044	5,973	5,913

Treguesit Financiarë IRIS

Nisur nga synimi i punës së AMF-së për ngritjen e një tregu financiar të stabilizuar dhe me qëllim kalimin në drejtim të metodës të mbikëqyrjes me fokus riskun, gjatë vitit 2012 kanë vijuar të përdoren treguesit e paralajmërimit të hershëm.


Kështu, në analizën e gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve, në vlerësimin e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, përdoren edhe treguesit e paralajmërimit të hershëm, të rekomanduara nga Banka Botërore për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në Shqipëri.

Këto tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg.

Tabelë 13: Diapazonet e vlerave të treguesve financiarë IRIS

(në %)

Raporti	31.12.2010	31.12.2011	31.12.2012	Kufiri	
				MIN	MAX
Norma e rritjes së primit	2.73	- 1.06	10.94	-40	40
Raporti i mbajtjes neto	84.37	81.61	76.89	40	80
Raporti dëme/prime neto	32.86	42.97	34.27	50	80
Raporti i shpenzimeve	62.28	73.98	62.78	25	50
Raporti i kombinuar	95.14	116.96	97.05	85	105
Të ardhurat nga investimet	8.04	7.67	6.37	4	8
Raporti i kapitalit	69.83	57.00	55.30	20	50
Raporti i provigjoneve teknike	96.51	66.78	73.43	10	30
Raporti i aftësisë paguese	439.5	333.30	346.00	150	300



Norma e rritjes së primeve të tregut të sigurimeve është brenda kufijve të përcaktuar. Kështu më 31.12.2012, norma e rritjes së primeve të tregut të sigurimeve është 8.95% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Raporti i mbajtjes neto në tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës është në masën 76.89%, ndërkohë që normat e përcaktuara ndërkombëtare rekomandojnë vlera midis 40 – 80%.

Raporti dëme/prime për tregun shqiptar të sigurimeve të Jo-Jetës ka arritur në 34.27%. Ky raport ka pësuar rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Raporti i shpenzimeve në masën 62.78%, ka patur një tendencë në ulje gjatë vitit 2012. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 65.78% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës.

Raportet financiare të mësipërme ilustrohen në tabelat e mëposhtme në mënyrë grafike për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës për periudhën më 31.12.2012.

Grafik 9: Treguesit IRIS 2012



Inspektime në vend (*on-site*) në subjektet e mbikëqyrura

Përmes inspektimeve në vend merret informacion i detajuar, i cili ndihmon në vlerësimin e aktivitetit financiar aktual dhe të pritshëm për subjektin në mbikëqyrje.

Në mënyrë specifike, objektivi i inspektimit në vend është vlerësimi i aftësisë paguese aktuale dhe të pritshme të shoqërisë duke krahasuar profilin e riskut të subjektit, me kapacitetin e mbajtjes së këtij risku dhe të identifikojë çdo problem që mund të influencojë në aftësinë e tij për t'ju përgjigjur detyrimeve afatgjata kundrejt konsumatorëve.

Për realizimin e objektivave të inspektimit, personeli inspektues mund të intervistojë drejtuesit apo personat përgjegjës të subjektit që mbikëqyret, në lidhje me çështjet e mëposhtme:


- Veprimtarinë aktuale të subjektit;
- Strategjinë e biznesit të tij;
- Zhvillimet që kanë ndodhur që nga inspektimi i fundit;
- Masat korrigjuese për dobësitë, problemet apo shkeljet e konstatuara në inspektimet e mëparshme dhe zbatimin e tyre;
- Efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Shërbimet, produktet, shtrirja e aktivitetit, investime të reja;
- Sisteme të reja kompjuterike, në funksion të plotësisht të kërkesave rregullatore ligjore në fuqi.

Inspektimet e paplanifikuara në vend ushtrohen nëse AMF ka sinjale për probleme financiare të subjekteve të mbikëqyrura, ndryshime të konsiderueshme në menaxhimin e subjektit, ndryshime në strukturën e subjektit (shkriroje, bashkim të tij, etj), transferim portofoli, ankesa të të siguruarve, etj. Tabela më poshtë paraqet inspektimet e kryera në subjektet e mbikëqyrura.

Tabelë 14: Inspektimet e kryera sipas viteve

(në numër)

Emërtimi	Viti 2011	Viti 2012
Inspektime të plota të planifikuara	10	16
Inspektime tematike të planifikuara	8	9
Inspektime tematike të paplanifikuara	1	3
Inspektime të përbashkëta	3	3
Inspektime gjithsej	22	31



Inspektime në Subjektet e Mbikëqyrura

Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve

Inspektimi në shoqëritë e sigurimeve u përqendrua në verifikimin e elementëve të pasqyrave financiare, bazuar në problematikat e konstatuara nga analizat dhe raportet e hartuara nga mbikëqyrja, si edhe informacione të tjera analitike, që kërkojnë verifikim të mëtejshëm dhe të menjëhershëm.

AMF gjatë vitit 2012 ushtroi inspektime të plota dhe të planifikuara në vend në të gjitha shoqëritë e sigurimit (Jetë dhe Jo-Jetë). Edhe gjatë këtij viti, objekti i këtyre inspektimeve u fokusua jo vetëm në inspektimin e dokumentacionit pranë shoqërive, por edhe në shqyrtimin e tematikave që lidhen me ndryshimin e filozofisë së mbikëqyrjes drejt asaj me fokus riskun. Inspektimet synonin:

- Verifikimin e elementëve të pasqyrave financiare të këtyre shoqërive për vitin 2011 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2012;
- Verifikimin e përputhshmërisë së politikave dhe procedurave të brendshme të shoqërive të sigurimit me praktikën e konstatuara lidhur me marrjen në sigurim, limitet e mbajtjes së rrezikut, të specifikuara sipas llojit të produktit të marrë në sigurim;
- Verifikimin e dëmeve në proces gjyqësor, duke u përqendruar kryesisht tek dëmet shëndetësore, si dhe politikën e trajtimit të tyre nga shoqëritë e sigurimit;
- Verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore lidhur me vlerësimin dhe menaxhimin e dëmeve, praktikën e provigjonimit, si dhe aspekte që lidhen me risigurimin;
- Analizën e përgjegjësive të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit për vitin 2011, me qëllim evidentimin e menaxhimit të riskut në rreziqet e siguruara nga shoqëritë, pagesat e risiguresve, si edhe reflektimi i tyre në llogaritjet e rezervës së risiguresve;
- Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve e raporteve të inspektimit të AMF-së, lidhur me rolin e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm në drejtim të vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit me bazën ligjore në fuqi dhe me politikën dhe procedurat e brendshme të shoqërisë;
- Verifikimin e efektivitetit të sistemeve të informacionit të shoqërive të sigurimit, lidhur me punonjësit e përfshirë në menaxhimin e sistemeve informatike të shoqërive të sigurimit dhe planin e investimeve të këtyre shoqërive për teknologjinë e informacionit;
- Verifikimin e zbatimit të vendimeve të Bordit dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.


Gjetjet e konstatuara nga këto inspektime iu komunikuan shoqërive të sigurimit. Mbi bazën e tyre AMF ka dhënë rekomandimet përkatëse, lidhur me:

- Administrimin e rrezikut nga shoqëritë e sigurimit;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve në proces gjyqësor;
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- Vlerësimin e përgjegjësive të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm të shoqërisë lidhur me efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, rregullave të funksionimit dhe të ushtrimit të kontrollit të brendshëm si edhe të cilësisë së raporteve të kontrollit të brendshëm;
- Përmirësimin e politikave, procedurave dhe standardeve teknologjike që lidhen me sigurinë e sistemeve të informacionit.

Inspektime në fondet e pensioneve private vullnetare dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive

AMF me qëllim administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar dhe asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ushtroi inspektim të plotë në vend në shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe depozitarëve të tyre. Ky inspektim përfshinte periudhën që nga licencimi për herë të parë i këtyre shoqërive deri në periudhën e raportimit të fundit financiar të këtyre shoqërive në Autoritet. Në përputhje edhe me kërkesat e Ligjit nr. 10197 datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar” dhe Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, objekti i këtyre inspektimeve u përqendrua në drejtimet e mëposhtme:

- Verifikimi i kontratave dhe prospektit të fondit të pensionit dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive;
- Verifikimi i kontratave në fuqi të depozitarit me shoqërinë administruese;
- Njohja me politikën e investimit, llojet e investimit të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- Njohja me rregulloret e brendshme të funksionimit të shoqërisë administruese;
- Verifikimi i procedurave të llogaritjes së vlerës neto të asetëve të fondit të pensionit privat vullnetar dhe çmimit të kuotës;
- Verifikimi i procedurave të llogaritjes së vlerës neto të asetëve për kuotë, ose aksion të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe frekuenca e përcaktimit të kësaj vlere;
- Sistemet e informacionit që përdoren nga shoqëria administruese dhe depozitari për llogaritjen e vlerës neto të asetëve të fondit të pensionit privat vullnetar dhe çmimit të kuotës dhe vlerës neto të asetëve për kuotë ose aksion të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- Zbatimi i procedurave të transferimit të asetëve të anëtarit të një fondi, nga fondi i mëparshëm në fondin e ri të pensionit;



- Verifikimi i kontratave me tërheqje të parakohshme;
- Organizimi i funksionit të Auditit të Brendshëm dhe Administrimit të Riskut;
- Verifikimi i transaksioneve me palë të lidhura.

Gjetjet e konstatuara nga këto inspektime iu komunikuan shoqërive administruese të fondeve të pensioneve private vullnetare. Mbi bazën e tyre AMF ka dhënë rekomandimet përkatëse, lidhur me:

- Funksionimin e sistemeve të informacionit, të cilët të bëjnë të mundur llogaritjen e saktë të vlerës neto të aseteve të fondeve të pensionit si dhe çmimit të kuotës;
- Rakordimet ditore të vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit dhe çmimit të kuotës, midis depozitarit dhe shoqërisë administruese të fondeve të pensionit;
- Njoftimin periodik mujor të anëtarëve të fondeve të pensioneve mbi gjendjen e llogarisë së tyre të pensionit dhe çmimit të kuotës.

Konkluzionet dhe rekomandimet që rezultuan nga inspektimet e kryera, shërbyen si bazë për analizën e gjendjes financiare të shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në periudhat përkatëse.

Inspektime të përbashkëta

Gjatë 2012, AMF në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, ka kryer inspektim të përbashkët tematik në sistemin bankar me qëllim verifikimin në vend:

- Të kontratave të garancisë dhe të kreditit të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, me qëllim verifikimin e një ekspozimi agregat të shoqërive të sigurimit në lidhje me këto produkte;
- Të të gjitha vlerave monetare të shoqërive të sigurimit, të vendosura në bankë për t'u ruajtur gjatë vitit, me destinacion qëllimor;
- Të të dhënave të transaksioneve bankare të policave sigurimit të detyrueshëm motorik të shitura dhe të raportuara në AMF në kuadër të zbatimit të projektit "Integrimi i Regjistrimit të Policave me shitjen nëpërmjet Sistemit Bankar".

Gjatë vitit 2012 është kryer një inspektim i përbashkët me e punonjësit e Policisë Rrugore të Durrësit, Elbasanit dhe Lezhës. Ky inspektim ishte në vazhdimësi të planit të veprimit të datës 29.09.2011 i cili ishte në zbatim të Urdhrit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Qëllimi i këtij inspektimi ishte zbatimi i dispozitave të Ligjit nr. 10076 datë, 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", në lidhje me evidentimin dhe verifikimin e mjeteve motorike:

- Pa polica të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Me polica të parregullta të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe të paraportuara në kohë reale në AMF, në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Nga inspektimi u konstatuan disa parregullsi në raportimin e të dhënave të detyrueshme në "Regjistrin online të sigurimeve të detyrueshme motorike" të AMF-së. Gjithashtu, rezultoi se vetëm 0.65% e mjeteve të kontrolluara nuk ishin të pajisura me policë sigurimi të detyrueshëm DMTPL.

AMF do të vazhdojë bashkëpunimin me Drejtorinë e Policisë Rrugore, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe për të kontribuar në rritjen e sigurisë rrugore kombëtare.

Inspektime të tjera në vend


Gjatë vitit 2012, AMF ka ushtruar një inspektim pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) lidhur me aktivitetin e ushtruar prej saj gjatë periudhës së viteve 2009-2011.

Inspektimi u përqendrua në:

- Mbikëqyrjen e veprimtarisë së BSHS-së, në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, si dhe procedurat për ndjekjen dhe arkëtimet nga Padi të Regresit;
- Zbatimi i detyrimeve ligjore që lidhen me administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil, përdorimin e tij në rast të mosshlyerjes së detyrimeve të anëtarëve të BSHS-së (shoqërive të sigurimit);
- Rastet e mospërbushjes së detyrimeve financiare nga këta anëtarë ndaj BSHS apo shoqërive të huaja të raportuara nga Këshilli i Byrove;
- Trajtimin e dëmeve ku shkaktarë janë mjetet me targa të huaja dhe zbatimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove për trajtimin e këtyre rasteve.

Nga inspektimi i kryer rezultuan problematikat e mëposhtme:

- Vonesa në pagesën e dëmeve, të cilat i takojnë Fondit të Kompensimit, prej shoqërive të sigurimit, tej afateve ligjore të përcaktuara;
- Vonesa dhe në disa raste edhe mosngritje të padive të regresit, ndaj shkaktarëve të aksidenteve të cilët kanë qenë të pasiguruar datën e aksidentimit;
- Mangësi e theksuar në ndjekjen e arkëtimeve të padive të regresit edhe prej atyre çështjeve që janë fituar në gjykatë.



Byroja Shqiptare e Sigurimit, nga viti 2001 deri në tetor të vitit 2012, ka paguar dëme për llogari të Fondit të Kompensimit, për 1625 praktika dëmshme në një vlerë prej 878,647,198 lekë. Nga ana e Byrosë, gjatë gjithë kësaj periudhe janë ngritur vetëm 841 padi regresi, me një vlerë prej 411,881,833 lekë, ndërkohë që janë arkëtuar vetëm 197 raste me një vlerë prej 27,378,352 lekë, ose rreth 3% të shumës së paguar.

Nisur nga konstatimet e këtij inspektimi dhe me qëllim përmirësimin e situatës, AMF ka propozuar edhe masa administrative ndaj BSHS dhe shoqërive të sigurimit në mënyrë që të përmbushen sa më mirë dhe në çdo kohë të gjitha funksionet e BSHS.

Masat korrigjuese dhe administrative

Mbrojtja e konsumatorit, forcimi i besimit të tij për rolin e AMF-së, si edhe parandalimi i fenomeneve negative që shfaqen gjatë veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura ka qenë synimi dhe objektivi i AMF-së nëpërmjet marrjes së masave administrative, parandaluese dhe korrigjuese.

Me anë të masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, AMF ka synuar t'i paraprihet dhe të parandalohen problematikat në tregjet e mbikëqyrura. Kjo ka sjellë edhe përmirësime në treg. Vendosja e masave është bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumentacionin, shqyrtimin e informacionit, apo ankesave të depozituara. Autoriteti ka treguar gjithnjë paanshmëri dhe transparencë në vendosjen e këtyre masave, të cilat gjithnjë reflektojnë gjetjet e arritura nga ushtrimi i mbikëqyrjes.

Autoriteti ka punuar me kujdes në drejtim të njohjes, identifikimit të problematikave duke ndërmarrë masa përkatëse me qëllim zbatimin e tyre në praktikën e përditshme. Konstatimet kanë përfshirë shkelje të dispozitave të ligjit në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, rregullat e administrimit të riskut, raportimet e sakta dhe në kohë, organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm e sistemit të dëmshpërblimeve, etj.

Gjatë vitit 2012, AMF ka monitoruar edhe veprimtarinë e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, duke analizuar çështje që lidhen me zbatimin në praktikë të kësaj veprimtarie. Për rregullimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie, AMF ka organizuar trajnime për vlerësuesit e pavarur të dëmeve si edhe ka miratuar vendime të cilat standardizojnë mënyrën e raportimit si edhe unifikojnë praktikatat e akteve të vlerësimit.

Në varësi të çështjeve të evidentuara, AMF ka vepruar në vazhdimësi, duke kërkuar sensibilizimin e sistemit gjyqësor për kuadrin rregullativ, aktet nënligjore dhe udhëzimet e miratuara prej saj.

Masat e vendosura ndaj subjekteve të mbikëqyrura kanë ndikuar në një përmirësim të pozitave financiare të disa subjekteve si dhe kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut. Ndërsa në

rastet kur situatat janë përkeqësuar, ose kërkesat dhe rekomandimet janë anashkaluar, AMF ka proceduar në përshkallëzimin e masave parandaluese dhe korrigjuese.

Në përfundim të procesit mbikëqyrës AMF ka marrë 8 vendime për masa administrative, zbatimi i të cilave ndiqet në vijimësi. Prej këtyre masave, një është ankimuar në rrugë gjyqësore.

Gjatë vitit 2012 AMF ka qenë palë në 17 çështje gjyqësore. Nga të cilat 10 çështje gjyqësore janë ankimuar gjatë periudhës 2007-2011 të cilat janë ende në proces gjyqësor, ndërsa 7 të tjera janë çështje të ankimuara gjatë vitit 2012. Çështjet e ankimuara gjatë vitit 2012, janë kryesisht për 6 vendime të marra nga AMF në dhjetor 2011 për tërheqje licence si vlerësues dëmsh. Vetëm një ankimim është ndaj vendimit të marrë nga AMF gjatë 2012 për një sanksion me gjobë.

Parashikimet ligjore për masat administrative

Ligji nr. 9267 datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime" parashikon masa administrative si më poshtë:


- Urdhër për eliminim shkeljesh;
- Masa korrigjuese;
- Plan financiar;
- Gjobë subjektiv;
- Gjobë personit përgjegjës;
- Tërheqje licence;
- Administrim i përkohshëm;
- Likuidim.

Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", parashikon një sërë masash administrative që lidhen me veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të shoqërive të sigurimit. Masat administrative parashikojnë sanksione ndaj shoqërive të sigurimit, personave përgjegjës të shoqërive të sigurimit, drejtorit ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS), personave përgjegjës të BSHS.

Gjithashtu, Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009, parashikon masa administrative të qarta në lidhje me procedurat dhe afatet për rregullimin e shpërblimit të dëmit (neni 12). Për shkelje të këtij neni për shoqëritë e sigurimit parashikohen:

- Shpallje publike, me shpenzimet e veta (të shoqërisë) të të dhënave për praktika të gabuara;
- Tërheqje miratimi për anëtarët e organeve drejtuese;
- Tërheqje, të përkohshme ose përfundimtare të licencës për kryerjen e veprimtarisë përkatëse.

Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" parashikohen sanksione administrative për çdo person, ortak, apo aksionar të personit juridik, që pengon Autoritetin, strukturat, apo nëpunësit e tij për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.



Tabelë 15: Masa administrative të marra nga AMF, 2012

(në numër)

Përshkrimi i masës	Analizat e gjëndjes financiare	Inspektimi në shoqëri sigurimi	Inspektimi në Byronë Shqiptare të Sigurimit
Vendime Bordi	3	4	1
Urdhër eliminim shkelje	3		
Masa korrigjuese	1	4	1
Gjobë	1		
Paralajmëtime	1		

Në zbatim të legjislacionit në fushën e sigurimeve, AMF ka ndërhyrë me marrjen e masave administrative të cilat kanë synuar parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të shkeljeve të ligjit, si dhe korrigjimin e shkeljeve.

Tabelë 16: Proceset gjyqësore lidhur me masat administrative të marra nga AMF, 2012

(në numër)

Të përfunduara	Gjykatë e Lartë	Gjykatë e Apelit	Gjykatë e Rrethit
3	6	6	2

Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)

BSHS është person juridik, e krijuar jo për qëllime fitimi, në përbërje të së cilës është çdo sigurues i licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm motorik. Ajo është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove (Shoqata Ndërkombëtare e Byrove Kombëtare të Siguruesve Motorik) dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Roli i BSHS gjatë veprimtarisë së saj përmbledhet në:

- Përfaqësimin e anëtarëve në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të fushës së sigurimeve të detyrueshme në sektorin e transportit;
- Ratifikimin e marrëveshjeve me byrotë homologe;
- Kryerjen e funksioneve të byrosë trajtuese, paguese dhe të shërbimit, në përputhje me parashikimet e rregullores së brendshme të Këshillit të Byrove;
- Administrimin e Fondit të Kompensimit dhe Fondit të Kartonit Jeshil;
- Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore lidhur me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
- Furnizimin e anëtarëve me Certifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit (Kartoni Jeshil), sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli i Byrove;
- Bashkëpunon me strukturat shtetërore për çështjet që kanë lidhje me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Gjatë vitit 2012, Autoriteti ka ndjekur me përparësi detyrimet e shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë për financimin e Fondit të Kompensimit, buxhetit të BSHS, kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit si edhe përmbushjen e detyrimeve nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.

Fondi i Kompensimit

Fondi i Kompensimit ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti të pasiguar, të pidentifikuar dhe në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie të sigurimit. Ai krijohet nga:


- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin e detyrueshëm motorik;
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmet të Byroja;
- Gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera të cilat nuk ndalohen me ligj.

Duke qenë se gjatë këtij viti, janë konstatuar vonesa nga shoqëritë, në plotësimin e këtyre detyrimeve dhe pagesave, si dhe nisur nga fakti se ky fond ka qenë në rritje të vazhdueshme, Autoriteti ka marrë disa vendime lidhur me masën e kontributit të Fondit të Kompensimit për vitin 2012, për shtesa të këtij fondi si dhe për mënyrën e financimit të tij nga ana e shoqërive të sigurimit.

AMF, në zbatim të nenit 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, për vitin 2012, ka miratuar Fondin e Kompensimit në masën 150 milionë lekë. Gjatë këtij viti, pasi është konstatuar se Fondi i Kompensimit i miratuar për vitin 2012, ishte i pamjaftueshëm, Autoriteti për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji ka miratuar shtesën e këtij Fondi në masën 100 milionë lekë.

Shoqëritë e sigurimit kanë përmbushur detyrimet për financimin e Fondit të Kompensimit të miratuara nga AMF. Pavarësisht se ky detyrim prej 250 milion lekësh është shlyer totalisht nga shoqëritë gjatë vitit 2012, përsëri situata e dëmeve të papaguara që i përkasin Fondit të Kompensimit nuk është e mirë. Kështu, shumica e dëmeve të miratuara, por të papaguara nga ky fond në 31.12.2012 arrinte në vlerën 459,794,942 lekë.

Nisur nga kjo situatë e krijuar pranë Byrosë, AMF ka ndërmarrë një sërë hapash në shërbim të përmirësimit të situatës me Fondin e Kompensimit. Kështu, për vitin 2013, Autoriteti ka kërkuar nga shoqëritë që të paraqesin propozimin e tyre për Fondin e Kompensimit, si dhe mbajtjen e një rezerve për Fondin e Kompensimit deri në vlerën totale të dëmeve të miratuara të papaguara, të cilat janë të mbartura nga vitet e mëparshme.



Autoriteti, në bazë të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, mbikëqyr Byronë Shqiptare të Sigurimit

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Garantimi i detyrimeve financiare, që rrjedhin nga anëtarësimi i Byrosë në sistemin e Kartonit Jeshil;
- Zbatimi i detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit;
- Zbatimi i detyrimeve të tjera ligjore që lidhen me veprimtarinë e BSHS-së.

Realizimi i mbikëqyrjes kryhet nëpërmjet:

- Raportimeve periodike të BSHS lidhur me;
 - financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit,
 - financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil,
 - financimin, investimin dhe administrimin e Buxhetit të BSHS,
- Inspektimeve tematike.

2.4 Teknologjia e informacionit

Përgjatë vitit 2012, vëmendja kryesore e aktiviteteve lidhur me teknologjinë e informacionit (TI) në AMF ka qenë zhvillimi i infrastrukturës së shërbimeve të integruar me sistemet informatike në veçanti në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të projekteve me partnerët ndërkombëtarë.

AMF ka zhvilluar sisteme në përmbushje të nevojave të mbikëqyrjes së tregjeve, operatorëve të tij, mbrojtjes së konsumatorëve si dhe aktivitete për projektimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike të brendshme. Nisur nga ky synim janë siguruar administrimi i vazhdueshëm i infrastrukturës informatike, pajisjeve, aplikimeve, bazës së të dhënave, menaxhimit dhe sigurisë informatike dhe ndihma e vazhdueshme teknologjike për punonjësit e institucionit.

Gjatë vitit 2012 është projektuar dhe ndërtuar sistemi, i cili ndërthur infrastrukturën ekzisuese me kontrollin në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, finalizuar me përdorimin e këtyre të dhënave në kohë reale në sistemin E-Gjoha. Ky sistem është në zbatim të një prej tematikave të rëndësishme të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit” nënshkruar midis AMF, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.



Departamenti i Kërkimit, TI dhe Statistikës

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, DPSHTR, është realizuar lidhja në kohë reale me regjistrin kombëtar të mjeteve motorike. Shërbimet e mësipërme janë rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm edhe me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik


Gjatë vitit 2012 është siguruar vazhdimësia e funksionimit të regjistrave elektronikë në AMF dhe janë realizuar edhe ndryshime strukturore, me qëllim optimizimin e aplikacioneve përbërëse dhe rritjen e shkallës së sigurisë e vazhdimësisë së shërbimeve.

Në bashkëpunim me BB në kuadër të projektit mbi Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri (The Road Ahead for Albanian Motor TPL Market) pranë Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik përgjatë vitit 2012 është vënë në zbatim baza informatike mbi të cilën do të mundësohet saktësimi i të dhënave të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik me qëllim përqasjen e vlerësimit dhe mbikëqyrjes me bazë risku si dhe mundësimin e sistemit Bonus-Malus.

Në muajt e parë të vitit 2013, parashikohet të shfaqen për tregun të dhënat mbi të cilat shoqëritë e sigurimit mund të përlogarisin tarifën duke u bazuar në një informacion më të plotë mbi mjetin, pronarin, dhe certifikatën Bonus-Malus të çdo drejtuesi. Pas realizimit të këtij komponenti, AMF do të bashkëpunojë me tregun për zbatimin e sistemit Bonus-Malus.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik është realizuar dhe mirëmbahet nga AMF në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit. Ajo përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar. Regjistri Elektronik është në përdorim e mirëmbajtje në AMF nga dhjetori 2007;
- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike është një platformë raportimi i dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike. Për të mundësuar fazën e tretë të projektit, krijimin e sistemit Bonus-Malus, Regjistri i Dëmeve është plotësuar me të dhënat historike të dëmeve duke filluar nga 1 janari 2006. Regjistri i Dëmeve është në përdorim në AMF dhe e mirëmbahet prej tij që nga gushti i vitit 2009.




Sistemi i Administrimit të Informacionit

Në kuadër të kalimit drejt raportimit elektronik të subjekteve në mbikëqyrje, AMF ka tashmë në përdorim të vazhdueshëm sistemin AMF In-Reg. Ky sistem është realizuar me ndihmën financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH).

Sistemi AMF In-Reg përbëhet nga një platformë raportimi në web, nëpërmjet të cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit.

Drejtoria TI, si pjesë e grupit të punës që menaxhon sistemin, gjatë vitit 2012 ka marrë pjesë intensivisht në procesin e saktësimit të funksionimit dhe ndërtimit të pjesëve të reja të sistemit. Këto kishin të bënin si me formatet e raportimit të plotësuar nga subjektet e mbikëqyrura ashtu edhe me raportet analitike bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet formateve të raportimit.

Ky sistem për administrimin e informacionit është në përdorim dhe mirëmbajtje nga AMF. Sistemi përdoret edhe nga shoqëritë raportuese.



Sistemi Telefonik i Ndihmës së Konsumatorëve

“Sistemi Telefonik i Ndihmës së Konsumatorëve” përpunon automatikisht telefonata nga numri telefonik i konsumatorit, pa pagesë **0800 6969** dhe nga numri **+355 4 2269329** i publikuar në faqen zyrtare të internetit të AMF-së.

Sistemi jep të dhëna zanore në formë të automatizuar dhe mundëson bashkëveprimin me strukturat përkatëse të AMF-së (me zë, e-mail, apo faqen zyrtare të internetit) si dhe mbikëqyrjen nga drejtuesit të veprimtarisë së kujdesit ndaj konsumatorit në përgjithësi dhe çdo çështjeje në veçanti. Gjatë vitit 2012 ka patur mbi 400 thirrje të hyra në sistem.

Sistemi SMS i mbështetjes së konsumatorëve

Gjatë vitit 2012 është realizuar dhe është në përdorim "Sistemi SMS i mbështetjes së Konsumatorëve". Ky sistem, i cili u projektua gjatë vitit të kaluar dhe filloi nga përdorimi gjatë vitit 2012, do të ndihmojë konsumatorët për të patur një shërbim më të shpejtë në mbështetje të tyre.


2.5 Bashkëpunimi institucional

Bashkëpunimi me institucionet e vendit

Në përmbushjen e misionit të **Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, GKSF**, Autoriteti si pjesëmarrës i këtij organizmi ka bashkëpunuar me **Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave** si në drejtim të formalizimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve, ashtu edhe në vlerësimin dhe analizimin e tregjeve financiare të mbikëqyrura. Në janar të 2012, edhe me mbështetjen e BB, u nënshkrua memorandum i mirëkuptimit midis këtyre institucioneve financiare. Ky memorandum identifikon disa objektiva konkrete dhe mundëson një harmonizim më të mirë të punës së autoriteteve në ushtrimin e rolit të tyre për ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Bashkëpunimi do të mbështetet mbi parimet e zhvillimit të një sistemi financiar të ekuilibruar e të rregullt, parandalimin e rreziqeve sistematike, përcaktimin e saktë të përgjegjësisë, shkëmbimin e rregullt të informacionit dhe koordinimin e përbashkët për zgjidhje të qëndrueshme të situatave. Në fokusin e axhendës së GKSF-së për vitin 2012 midis të tjerave, ka qenë rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për zhvillimin e tregjeve dhe institucioneve financiare, përgatitjen e Planeve të Posaçme të Veprimit, vlerësimin e rreziqeve sistematike, ruajtjen si dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore teknike dhe financiare nga secili institucion.

AMF ka bashkëpunuar ngushtë edhe me **Ministrinë e Brendshme** dhe **Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit**. Në kuadër të këtij bashkëpunimi dhe marrëveshjes së nënshkruar më parë për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit, AMF nënshkroi në qershor 2012 Marrëveshjen e Bashkëpunimit me **Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor**. Kjo marrëveshje mundëson kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme, zvogëlimin e numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara, kontrollet e përbashkëta dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të qarkullimit të mjeteve motorike.

Me **Bankën e Shqipërisë**, bashkëpunimi ka qenë i vazhdueshëm dhe tepër i frytshëm, në drejtim të arritjes së objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në vend. Gjatë vitit 2012, AMF ka shkëmbyer vazhdimisht informacione me Bankën e Shqipërisë për qëllime mbikëqyrjeje dhe statistikore, si edhe janë zhvilluar inspektime



të përbashkëta e takime në nivel ekspertësh, të cilat kanë rezultuar të suksesshme, në përmbushjen e funksioneve rregullatore të të dy insitucioneve.

Bashkëpunimi me **Autoritetin e Konkurrencës**, ka qenë edhe më i domosdoshëm përgjatë vitit 2012, në kuadrin e liberalizimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik. Nëpërmjet takimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme, si në nivel drejtuesish ashtu edhe në atë teknik, është diskutuar mbi koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta, në mënyrë që konsumatorët të kenë një treg të shëndetshëm financiarisht e që funksionon në përputhje me rregullat e konkurrencës së lirë.

Raportet dhe kontaktet e vazhdueshme të AMF-së me **Ministrinë e Integritit** kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2012. Në raportet e përgatitura AMF ka pasqyruar progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, sipas afateve të parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me *acquis communautaire* të akteve juridike të miratuara për tregun financiar nën mbikëqyrje. Më konkretisht:

- Raportim (me ndërmjetësimin e Ministrisë së Integritit) pranë Komunitetit Evropian, KE në lidhje me zhvillimet legjislativë, masat, projektet dhe kapacitetet institucionale;
- Raportim në lidhje me zhvillimet legjislativë, masat, projektet dhe kapacitetet institucionale në kuadër të hartimit Raportit të Progresit të R.SH. sipas Kapitujve të Pyetësorit ku AMF ka kontribut, si dhe raportime të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit të KE-së;
- Raportim vjetor mbi zhvillimet e tregut të sigurimeve, të titujve apo pensioneve private vullnetare të mbikëqyrura nga AMF;
- Raportim në kuadër të përgatitjes së raportit të Komitetit të Stabilizim-Asociimit dhe të takimit të Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës BE-Shqipëri;
- Raportim periodik i përditësuar për zhvillimet më të fundit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje në kuadër të plan-veprimit për adresimin e rekomandimeve të Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën BE-Shqipëri, Prill 2012.
- Raportim në lidhje me përditësimin e planit të veprimit të AMF-së në kuadër të rekomandimeve të Raportit Analitik 2010 dhe Raportit të Progresit 2011 të KE.
- Raportim periodik në kuadrin e realizimit të masave të parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, PKZMSA 2012-2015, për Kapitullin 9 dhe Kriterin Ekonomik.

AMF, në vitin 2012, aplikoi për të përfituar asistencë teknike nga programet e Bashkimit Evropian, në kuadrin e instrumentit **TAIEX, (Technical Assistance and Information Exchange.)** Aplikimet ishin të suksesshme dhe AMF ka përfituar asistencë teknike për pesë misione ekspertize të cilat do të realizohen gjatë vitit 2013. Fushat kryesore ku AMF do

të ndihmohet me ekspertizë lidhen me përshtatjen e legjislacionit me direktivat evropiane për sigurimin e detyrueshëm motorik, ndërgjegjësimin e mëtejshëm të publikut për sistemin e pensioneve private vullnetare, krijimin e një Depozitari Qendror për letrat me vlerë, mbikëqyrjen në grup për sigurimet si edhe mbikëqyrjen me bazë risku për fondet e pensioneve private vullnetare.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Harmonizimi i legjislacionit rregullues të tregjeve financiare nën mbikëqyrje me direktivat e Bashkimit Evropian si edhe me tendencat më të fundit ndërkombëtare, ka qenë ndër synimet e rëndësishme në veprimtarinë e AMF-së. Realizimit të këtyre synimeve i ka shërbyer edhe mbajtja e një komunikim të vazhdueshëm me institucionet homologe. Pjesëmarrja aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë, si edhe në forumet e nismat e ndryshme rajonale i kanë shërbyer reflektimit të praktikave më të mira në nismat rregullatore të ndërmarra nga AMF.


Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS)

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Sigurimeve, IAIS, që prej vitit 2001. AMF ndjek me interes procesin e filluar nga IAIS për nënshkrimin e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit (MMoU). Kjo është një marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni midis anëtarëve të IAIS, me qëllim vendosjen e standardeve të domosdoshme për të forcuar mbikëqyrjen ndërkufitare të shoqërive të sigurimit. Pjesëmarrja në këtë marrëveshje multilaterale është një mjet i rëndësishëm rregullator për të siguruar një mbikëqyrje të shëndoshë të tregut të sigurimeve dhe AMF e konsideron nënshkrimin e marrëveshjes me IAIS si një hap të rëndësishëm strategjik në axhendën e saj. AMF ka gjithë angazhimin për ndryshimet e nevojshme në kuadrin e saj rregullator me qëllim përmbushjen e standardeve dhe firmosjen e MMoU-së.

Konferenca Vjetore-2012 e IAIS-it me temë "Mbikëqyrja në Sigurime: Themelore për Fuqizimin Financiar Botëror" paraqiti sfidat e reja të tregjeve dhe ofroi alternativa zhvillimi që lidhen me mbikëqyrjen me bazë të gjerë dhe çështjet e industrisë, standardet e sigurimit, menaxhimin e riskut, mbrojtjen e konsumatorit, etj. AMF ka qenë gjithnjë pjesëmarrëse aktive në këto konferenca.

Gjatë vitit 2012, AMF ka qenë pjesëmarrëse me kontribut aktiv në IAIS. Kryetarja e AMF-së është anëtare e Nënkomitetit të Përfshirjes Financiare (*Financial Inclusion Subcommittee*) i cili promovon në veçanti tregjet dhe ekonominë në zhvillim lidhur me zbatimin e Parimeve Themelore të Sigurimeve për të mbështetur rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve dhe forma të tjera të veçanta të sigurimit.



Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO)

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, IOSCO dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Ky memorandum i ka shërbyer në vazhdimësi AMF-së për të shkëmbyer informacione të vlefshme me rregullatorë të tjerë të fushës së letrave me vlerë, duke përbërë një instrument të vlefshëm në mbikëqyrjen e këtij tregu.

AMF mban marrëdhënie të vazhdueshme me IOSCO, kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në mbledhjet e përgjithshme vjetore, të cilat shërbejnë si forume për shkëmbimin e pikëpamjeve në fushën e ruajtjes dhe përmirësimit të kuadrit rregullator ndërkombëtar të tregjeve të letrave me vlerë. AMF është gjithashtu e përfshirë edhe në Komitete dhe struktura të veçanta të IOSCO-s në shkallë rajonale e më gjerë, si në Komitetin Evropian (*European Regional Committee*) dhe Komitetin e Tregjeve në Zhvillim (*Emerging Market Committee*).

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)

AMF është anëtare në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS, që prej vitit 2006. Ky anëtarësim i ka shërbyer institucionit për të krijuar marrëdhënie të rëndësishme bashkëpunimi midis autoriteteve homologe në nivel global, të përfshira në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të pensioneve private vullnetare. Nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive në mbledhjet vjetore e takimet e ndryshme rajonale, AMF është njohur vazhdimisht me praktikën më të mira në fondet e pensioneve private. Ky bashkëpunim ka pasur ndikim pozitiv në promovimin e qasjeve të reja në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve dhe plotësimin e kuadrit rregullator, duke reflektuar praktikën më të mira.

Bashkëpunimi me institucione homologe

Bashkëpunimi me **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK)**, ka hyrë në një fazë konsolidimi sidomos në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në të dy vendet, pasi shoqëritë shqiptare të sigurimit kanë peshë jo të vogël në tregun e Kosovës. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis AMF-së dhe BQK-së ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ekspertizës midis dy institucioneve. Gjatë vitit 2012, kontaktet e bashkëpunimit me BQK në nivele të larta kanë qenë të frytshme. Guvernatori i BQK-së ishte folës në panelin e diskutimit lidhur me praktikën më të mira ndërkombëtare për pavarësinë e rregullatorëve në konferencën ndërkombëtare


"Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar" të organizuar nga AMF në 31 tetor 2012. Gjithashtu AMF ka zhvilluar takim me delegacionin qeveritar të Republikës së Kosovës, të kryesuar nga Zëvendëskryeministria, në përbërje të të cilit ishin edhe zyrtarë të lartë të Bankës së Kosovës. Bisedimet u përqendruan në mundësinë e tregtimit nga ana e siguruesve të Kosovës të Kartonit Jeshil të emetuar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit e cila sjell mjaft lehtësi dhe përfitime për qytetarët kosovarë që dëshirojnë të udhëtojnë jashtë Kosovës.

Që prej tre vitesh AMF ka nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)**. Edhe për kushtet aktuale të shtrirjes së veprimtarisë të kompanive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë, marrëveshja e ndikoi pozitivisht në integritetin, stabilitetin dhe efikasitetin e industrisë së sigurimeve të të dy vendeve duke shtrirë bashkëpunimin në të gjitha kanalet e komunikimit, rritjen e mirëkuptimit reciprok dhe shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave.

Në vazhdimësi të bashkëpunimit me autoritete homologe në fushën e pensioneve, AMF, nënshkroi në dhjetor 2012 Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkëpunim Teknik në fushën e pensioneve me **Agjencionin për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)** Maqedoni. Marrëveshja përfshin shkëmbimin e përvojave të dy institucioneve në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të pensioneve private vullnetare dhe kuadrit ligjor që rregullon këto fusha. Bashkëpunimi do të shtrihet edhe në aspektin teknik, si në shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit, dokumentacionit dhe organizmin e trajnimeve të përbashkëta. Ky bashkëpunim u parapri edhe nga zhvillimi i takimit rajonal me temë "Mbikëqyrja e pensioneve për vendet e Evropës Qendrore, Lindore, Azisë Qendrore dhe Kaukazit" i organizuar nga bashkëpunimi i disa organizatave si IOPS, IAIS dhe me mbështetjen e MAPAS, të Maqedonisë. Në takim u trajtuan tema të rëndësishme në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve private vullnetare që janë fusha prioritare të mbikëqyrjes së AMF-së.

AMF e ka shtrirë bashkëpunimin e saj edhe me autoritete homologe të tjera në Evropë. Gjatë vitit 2012 është konsoliduar bashkëpunimi me **Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA)**. Kjo edhe për faktin e rritjes së interesave austriake në tregun shqiptar të sigurimeve. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis AMF dhe FMA në vitin 2009, të dy autoritetet janë angazhuar në rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin më tej të eksperiencave. Kështu, edhe më iniciativën e FMA, është në proces mbikëqyrja e grupeve austriake që operojnë në tregun shqiptar.

FMA e Austrisë në bashkëpunim me **Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Hungarisë (HFSA)** u bënë nismëtarë të Iniciativës Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. AMF ishte pjesëmarrëse aktive e kësaj iniciative. Kjo iniciativë lindi me synim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e një forumi diskutimi me fokus në problematikat aktuale të vendeve të



rajonit. Gjatë 2012 janë zhvilluar takimi i tretë dhe i katërt i kësaj iniciative ku pjesëmarrja nga AMF ishte e nivelit më të lartë. Takimi i tretë u zhvillua në maj 2012, në Lubjanë, Slloveni pranë Autoritetit Slloven të Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Tematikat kryesore të diskutuara lidheshin me sfidat e sigurimit të katastrofave natyrore, ndikimin e zhvillimit dhe ndryshimit të risqeve sistemike në biznesin e sigurimeve, mbikëqyrjen e degëve dhe sfidat në mbikëqyrjen e grupeve.

Takimi i katërt u organizua nga FMA, në Vjenë, në dhjetor 2012. Diskutimet kryesore në këtë takim u përqendruan në drejtim të forcimit të strukturave të mbikëqyrjes, shkëmbimit të përvojave rreth mekanizmave alternative të zgjidhjes së kontestimeve në sigurime, produkteve të Sigurimit të Jetës parë në kushtet aktuale ekonomike, si edhe në rolin e bankave si ndërmjetës sigurimesh. Seanca e këtij takimi, "Strukturat Mbikëqyrëse Efektive" u drejtua nga përfaqësuesja e AMF-së. Seanca kishte në qendër të saj diskutimin për rishikimin e strukturave mbikëqyrëse rregullatore në funksion të promovimit të stabilitetit financiar, kalimin drejt mbikëqyrjes me bazë rrisht, përshtatjen e këtyre strukturave me parimet bazë të sigurimeve, etj.

Kjo nismë tashmë mund të konsiderohet e suksesshme, nisur nga interesimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja aktive e vendeve të rajonit, duke ruajtur dhe nxitur më tej frymën e bashkëpunimit efektiv mbi çështjet dhe problematikat e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregjeve të sigurimeve në rajon. AMF do të vijojë të jetë pjesë aktive e kësaj nisme edhe në të ardhmen.

Gjatë vitit 2012, AMF ka vazhduar bashkëpunimin edhe me organizma të tjerë që veprojnë në fushën e tregut të sigurimeve në Austri, si **Shoqata e Sigurimeve të Austrisë (VVO)**. Njëpëmjet takimeve të nivelit të lartë midis dy institucioneve, është synuar forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimi i përbashkët i përpjekjeve për të krijuar mundësi të reja zhvillimi për tregun shqiptar të sigurimeve si dhe për të mundësuar përthithjen e praktikave të konsoliduara që ofron një treg i zhvilluar si Austria. Kështu edhe me iniciativën e FMA, janë firmosur dy Marrëveshje Bashkëpunimi për mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në tregun shqiptar.

Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët

Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e efektive me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët kanë vazhduar t'i shërbejnë realizimit të projekteve strategjike dhe rritjes së kapaciteteve institucionale të AMF-së.

Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC) vazhdon të mbetet një nga partnerët kryesorë të AMF-së, në drejtim të asistencës teknike që i ka ofruar institucionit vitet e fundit.



Konferenca Ndërkombëtare "Ritheidsimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar"

Një nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë vitit 2012, ishte organizimi i konferencës ndërkombëtare “Ritheksimi i pavarësisë së autoritetit rregullator të sektorit financiar”, parë nga perspektiva e integritetit në Bashkimin Evropian dhe nga mësimet e nxjerra prej krizës më të fundit financiare botërore. Ky aktivitet tepër i rëndësishëm u realizua me mbështetjen e USAID, Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri realizuar nëpërmjet FSVC. Konferenca kishte pjesëmarrje të gjerë e të nivelit të lartë të autoriteteve rregullatore nga Evropa si edhe ekspertë të tregjeve të tjera financiare. Konferenca u përshëndet edhe nga Kryeministri i vendit Prof. Dr. Sali Berisha, Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Evropian, Z. Ettore Sequi, Drejtori i Misionit të USAID në Shqipëri, Z. Jim Barnhart, si edhe mjaft personalitete të tjera të vendit.

Veprimtaritë kryesore të bashkëpunimit institucional

Gjatë vitit 2012, AMF ka bashkëpunuar me organizma ndërkombëtare në nisma rajonale dhe globale

IAIS

- Mbledhje të Nënkomiteteve të Punës së IAIS, shkurt;
- Takimi rajonal “Mbikëqyrja Makroprudenciale e grupit”, maj;
- Takimi i 3-të “Nisma Rajonale e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve”, maj;
- Konferenca Vjetore “Mbikëqyrja në Sigurime: Themelore për Fuqizimin Financiar Botëror”, tetor;
- Takime pune me përfaqësues të Shoqatës Kombëtare të Shoqërive të Sigurimeve të Italisë (ANIA) dhe Institutin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Private dhe Interesave Kolektive (ISVAP), nëntor;
- Takimi i 4-të “Nisma Rajonale e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve”, dhjetor.

IOSCO


- Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian, shtator;
- Konferenca Vjetore, tetor;
- Mbledhjet e Komiteteve të Punës, tetor;
- Konferenca e Rajonit të Evropës Juglindore mbi Tregjet e Kapitalit, nëntor.

IOPS

- Takimi rajonal me temë “Mbikëqyrja e pensioneve” për vendet e Evropës Qendrore, Lindore, Azisë Qendrore dhe Kaukazit”, maj;
- Mbledhjet e Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike, qershor.

USAID/FSVC

- Komete lidhur me projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Konsultime lidhur analizat aktuariale të shoqërive të sigurimit, mars;
- Workshop rajonal “Mbrojtja e konsumatorëve në sigurime: Praktikat më të mira dhe standardet Ndërkombëtare”, qershor;
- Konsultime lidhur me mbikëqyrjen efektive të tregjeve të sigurimeve dhe mbrojtjen e konsumatorit, qershor;
- Konsultime lidhur me kuadrin ligjor, ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për AMF, qershor-gusht;
- Workshop “Mbikëqyrja me bazë riskun”, shtator;
- Konferenca Ndërkombëtare I “Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar”, tetor;
- Programi i trajnimit të trajnerëve për aktuarët, shtator;
- Konsultime lidhur me Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (EWS) tetor-nëntor;
- Konsultime lidhur me marrëdhëniet me publikun dhe organizmin e konferencave, tetor-nëntor



Konferenca nënvizoi ndër të tjera se pavarësia e autoriteteve rregullatore është një domosdoshmëri për arritjen dhe konsolidimin e zhvillimit. Një ambient transparent dhe i qëndrueshëm nxit besimin e konsumatorëve dhe njëkohësisht inkurajon konkurrencën e ndershme të të gjithë pjesëmarrësve në treg.

Duke theksuar praktikatat e tyre të deritanishme, drejtuesit e mjaft autoriteteve rregullatore nga rajoni, pjesëmarrës në konferencë, realizuan shkëmbim idesh dhe përjasje të praktikave më të mira për forcimin e rolit të autoriteteve rregullatore në tregjet financiare. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të autoriteteve rregullatorë nga Estonia, Holanda, Hungaria, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Serbia, Sllovenia, SHBA dhe Turqia. Me prezantime për çështje specifike për mbikëqyrjen dhe rolin e rregullatorëve në tregjet financiare u paraqitën ekspertët nga Banka Qendrore Europiane, Zyra e Komisionerit të Shtetit të Washingtonit, SHBA dhe ish Komisionerja e Departamentit të Bankave dhe Sigurimeve, Nju Xhersi, SHBA.

AMF, në vazhdim të bashkëpunimit me FSVC, gjatë vitit 2012 është ndihmuar në hartimin e programit të trajnimit për stafin teknik, për tema të interesit të veçantë që lidhen me mbikëqyrjen me fokus riskun, konsultime në lidhje me marrëdhëniet me publikun, asistencë në rishikimin e kuadrit ligjor për sigurimet dhe të AMF-së si dhe konsultime për analiza aktuariale të tregut të sigurimeve. FSVC ka qenë një ndër organizatat e rëndësishme mbështetëse ndër vite. Që prej themelimit të AMF-së, si rrjedhojë edhe e seriozitetit të treguar nga Autoriteti në hartimin dhe zbatimin e projekteve ndihmëse, kontributet e dhuruara të ekspertëve të FSVC-së në terma monetarë kanë arritur në rreth 2 milionë dollarë.



Pjesëmarrësit e workshop-it rajonal "Mbrotja e konsumatorëve në sigurime"

Një tjetër aktivitet rajonal i rëndësishëm, me mbështetjen e USAID ishte workshop-i rajonal me temë "Mbrotja e konsumatorëve në sigurime: Praktikatat më të mira dhe standardet Ndërkombëtare". Programi i këtij workshop-i kishte në qendër trajtimin e parimeve bazë të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime si edhe prezantimin e praktikave më të mira të fushës të vendeve të tjera në rajon dhe në Evropë. Tema e mbrotjes konsumatore në sigurime ishte në qendër të vëmendjes edhe gjatë takimeve dhe diskutimeve me specialistë e drejtues të AMF-së.

Në kuadrin e strategjisë afatgjatë të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve në linjë me metodologjinë e mbikëqyrjes me fokus riskun, AMF me mbështetjen e FSVC-së është duke zhvilluar një sistem të paralajmërimit të hershëm me bazë riskun. Puna për konceptimin e këtij sistemi ka filluar që në vitin 2011 dhe gjatë vitit 2012 u arrit të ndërtohej arkitektura e sistemit. Ky projekt do të vijojë edhe në vitet në vazhdim dhe do të ketë si qëllim kryesor

prioritizimin e siguruesve sipas risqeve dhe do të ndikojë shkallën e ndërhyrjes nga AMF në sigurues të caktuar sipas niveleve të riskut që ata paraqesin.

Një partner i rëndësishëm strategjik në përmbushje të misionit themelor të AMF-së ka qenë Banka Botërore, e cila vazhdimisht ka asistuar AMF në drejtim të konkretizimit të një sërë nismash të rëndësishme strategjike. Një ndër projektet më të rëndësishme vitet e fundit ka qenë projekti "Për një mbikëqyrje efektive", i cili dha dy produkte të rëndësishme, që janë: Metodologjia e Mbikëqyrjes me Fokus Riskun dhe projektligji "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit" në Shqipëri, që synon të mbështesë metodologjinë e re të mbikëqyrjes për tregun e sigurimeve.


Aktualisht BB po asiston AMF në projektin e përbashkët mbi Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik "Strategjia për tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik", të financuar nga First Initiative, projekt i cili ka filluar në shtator 2011. Gjatë vitit 2012 përfundoi hartimi i raporteve, që do të përcaktojnë strategjinë e mbikëqyrjes dhe të tarifimit të portofolit të sigurimit të detyrueshëm motorik në Shqipëri. Në të njëjtën kohë AMF ka punuar për të projektuar të gjitha zhvillimet e teknologjisë së informacionit, që përbëjnë infrastrukturën mbështetëse për zbatimin e strategjisë, në vitet në vazhdim. Aspekt tjetër i rëndësishëm i projektit janë: zhvillimi i një strategjie për menaxhimin e numrit të të pasiguarve dhe ngritja në të ardhmen e një baze të dhënash kundër mashtrimeve në sigurime.

Në kuadër të këtij projekti, me mbështetjen e BB, u bë e mundur vendosja e kontakteve në nivele teknike me Institutin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Private dhe Interesave Kolektive (ISVAP) dhe Shoqatën Kombëtare të Shoqërive të Sigurimeve të Italisë (ANIA). Vlerësimi i eksperiencës italiane është tepër i rëndësishëm, si vendi i fundit i Evropës perëndimore, që kaloi procesin e liberalizimit të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Gjatë vitit 2012, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Partnerët për Stabilitet Financiar (PFS) në kuadër të projektit për ngritjen e mekanizmave të tregtimit të letrave me vlerë në nivel rajonal. Në këtë projekt janë përfshirë tetë bursa të rajonit, midis tyre edhe Bursa e Tiranës. Në kuadër të projektit janë parë eksperiencia dhe disa modele të ngjashme në vendet e Bashkimit Evropian.

2.6 Integrimi Evropian

Hartimi dhe përpunimi i vijueshëm i kuadrit ligjor e rregullativ përkatës ka qenë një nga shtyllat kryesore mbi të cilat është mbështetur në vijimësi zhvillimi institucional i AMF-së. Ky kuadër ligjor i plotësuar synon përafrimin me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, pasqyrimin e ndryshimeve që pëson tregu financiar nën mbikëqyrje në Shqipëri, si dhe forcimin e mekanizmave në mbrojtje të konsumatorit.



Angazhimet e AMF-së në kuadër të Dokumenteve Strategjike

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, MSA

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për AMF-në lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare jo-bankare, si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

Neni 70 i MSA-së parashikon detyrimin për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë gjatë fazës së parë tranzitore. Në Nenin 50 të saj, Shqipëria është angazhuar që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, t'u ofrojë shoqërive komunitare si dhe degëve dhe filialeve të tyre një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u njihet kompanive, degëve apo filialeve shqiptare. Në Nenin 57 të Marrëveshjes, Shqipëria angazhohet të lejojë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë komunitare, pa qenë nevoja për t'u vendosur. Neni 89 i MSA-së përcakton për një bashkëpunim prioritar ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën bankare, të sigurimeve dhe shërbimeve financiare. Palët duhet të bashkëpunojnë me qëllim vendosjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e sektorit bankar dhe financiar jo-bankar.

Partneriteti Evropian 2007

Në kuadër të dokumentit të Partneritetit Evropian 2007 është marrë angazhim të forcohet kuadri rregullator për mbikëqyrjen financiare bankare dhe jo-bankare, si dhe kapacitetet e Autoritetit.

Rekomandimet e Raportit Analitik 2010, Progres Raportit 2011 dhe Progres Raportit 2012

AMF ka marrë angazhime për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të sektorit financiar nën mbikëqyrje me Direktivat Evropiane, si dhe përforcimin e kapaciteteve institucionale me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen sa më efikase për tregjet nën mbikëqyrje.

Një nga objektivat kryesore të Autoritetit, që prej krijimit e në vazhdimësi, ka qenë dhe mbetet hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare nën mbikëqyrje duke mundësuar zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Komisioni Evropian publikoi më 10.10.2012 Raportin e Progresit për Shqipërinë, i cili përshkruan arritjet e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës tetor 2011-shtator 2012. Ky është raporti i dytë për progresin e Shqipërisë, pas publikimit të Opinionit të Komisionit për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE, i nxjerrë në nëntor të vitit 2010. Në Raportin e Progresit paraqitet ecuria e Shqipërisë, e cila matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Po kështu Raporti bën një përmbledhje të vlerësimit të KE mbi përparësitë dhe problematikat në 33 fushat e ndara sipas *acquis communautaire*.

Komisioni Evropian-Progres Raporti 2012 për Shqipërinë

(Kapitulli 9-Shërbimet financiare)

AMF-së i mungojnë kapacitetet e duhura administrative, të mbikëqyrjes dhe stafi i saj ka mbetur i pandryshuar.

Përfundim

Janë bërë disa përparime në fushën e shërbimeve financiare. Legjislacioni është harmonizuar me *acquis* në fushën e bankave dhe tregu i investimeve është zhvilluar më tej. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me sigurimet dhe pensionet e punës, infrastrukturën e tregut financiar dhe të tregut të letrave me vlerë, të investimeve dhe shërbimeve. Kapacitetet administrative në sektorët bankarë dhe jo-bankarë mbeten të pamjaftueshëm. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

Gjatë vitit 2012, AMF ka dhënë kontributin në rishikimin e PKZMSA-së 2012-2015, ku janë parashikuar masa afat shkurtër dhe afat-mesme, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, si dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së në tërësi dhe zbatimin e tij për sektorin financiar nën mbikëqyrje. Po kështu në kuadrin e PKZMSA 2012-2015, AMF përfundoi procesin e ndarjes së *acquis communautaire* dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale për përafrimin e legjislacionit tonë me direktivat e BE-së.


Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA)

*Çdo vend kandidat që aspiron të bëhet anëtar i BE-së, është i detyruar që të përgatisë një plan kombëtar për miratimin e *acquis communautaire**

PKZMSA është një dokument i konsoliduar që përfshin në tërësinë e tij prioritetet dhe masat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Shqipërisë për zbatimin e MSA-së në procesin e integritimit evropian, duke u fokusuar veçanërisht në:

- Prioritetet e Partneritetit Evropian për Shqipërinë të vitit 2007;
- Rekomandimet e Progres Raportëve vjetore të KE-së;
- Zbatimin e angazhimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Përcaktimin e prioritetëve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*;
- Përcaktimin dhe detajimin e kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e angazhimeve të MSA-së sipas fushave;
- Përcaktimin e kostove financiare për zbatimin e angazhimeve të MSA-së, në përputhje me planin buxhetor afatmesëm dhe me kostot e tjera financiare, të përcaktuara në strategjitë sektoriale.

Gjatë vitit 2012, AMF ka përgatitur dhe prezantuar informacionet e kërkuara në takimet periodike midis Shqipërisë dhe BE-së. Në takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit të muajit mars 2012, u trajtuan të gjitha arritjet legjislative dhe institucionale në drejtim të zbatimit të MSA-së.



Acquis communautaire

Acquis communautaire është tërësia e të drejtave dhe e detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha Shtetet Anëtare në Bashkimin Evropian. Acquis communautaire ndryshohet vazhdimisht.

Acquis communautaire përfshin:

- Pëmbajtjen, parimet dhe qëllimet politike të Traktateve;
- Legjislacionin e miratuar në zbatim të traktateve dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së;
- Deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga BE;
- Masat në lidhje me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë;
- Masat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme;
- Marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara nga Komuniteti dhe marrëveshjet e përfunduara me shtetet anëtare ndërmjet njëra-tjetrës në fushën e veprimtarive të BE.

AMF mori pjesë në takimin e tretë të Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën” që u zhvillua në Tiranë, në datën 24 prill 2012. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i zhvillimeve legjislative dhe institucionale të Shqipërisë në fushat e tregut të brendshëm dhe konkurrencës dhe vlerësimi nga pala evropiane i progresit të bërë nga Shqipëria në përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga dokumentet strategjike si MSA, Partneriteti Evropian, Raporti Analitik dhe Raporti i Progresit i KE-së. AMF në këtë takim paraqiti një raport mbi tregjet nën mbikëqyrje, duke u fokusuar në aspektin e zhvillimeve legjislative, ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. **Delegacioni i KE-së përshëndeti zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe theksoi domosdoshmërinë e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe fuqizimin e pavarësisë së AMF-së.**

Nga fjala e Z. Ettore Sequi, Ambasador i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë gjatë konferencës “Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar”, organizuar me 31 tetor 2012

Kriza ekonomike dhe financiare e ka shndërruar mbikëqyrjen financiare dhe konsolidimin fiskal në një imperativ për vendet në BE-së dhe në krejt botën. Përpërsitë e përgjithshme të BE-së për reformën financiare mbeten të qarta:

- Zhvillimi i një kuadri reagues më të efektshëm për mbikëqyrjen;
- Forcimi i mjeteve për të siguruar qëndrueshmëri financiare;
- Përmirësimi i aftësisë rregulluese të ekonomisë së BE-së nëpërmjet funksionimit më të mirë të tregjeve.

Raporti i Progresit për Shqipërinë për vitin 2012 vëren se legjislacioni shqiptar në fushën e shërbimeve financiare është pjesërisht në përputhje me standardet e BE-së. Nevojiten të bëhen përpjekje të tjera për të:

- Forcuar pavarësinë e rregullatorëve financiarë;
- Përafruar më tej legjislacionin me *acquis* të BE-së, dhe
- Shtuar kapacitetet administrative.

Përpjekje të tjera janë po ashtu të nevojshme të bëhen në fushat e infrastrukturës së tregut financiar si dhe shërbimeve të tregut të letrave me vlerë dhe investimeve.

Angazhime të tjera


- Autoriteti është anëtar i grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen dhe organizimin e veprimtarive në kuadër të marrëveshjes Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (Central European Free Trade Agreement, CEFTA). Shqipëria kishte drejtimin e CEFTA-s për vitin 2012. Autoriteti dha kontributin e tij për plotësimin e draft-skedulit të tregtisë së shërbimeve, në kuadër të marrëveshjes CEFTA, për pjesën e shërbimeve financiare nën mbikëqyrje, si dhe mori pjesë në “Javën e CEFTA-s” që u mbajt në Tiranë në datat 7-8 Nëntor 2012, e cila pati në fokus liberalizimin e tregtisë në mallra dhe shërbime, eliminimin e barrierave ndaj tregtisë midis palëve pjesëmarrëse të kësaj marrëveshjeje e nxitjen e investimeve.
- Si anëtar i grupit teknik të zbatimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar “Për hetimin e krimit financiar” AMF gjatë vitit 2012 ka rritur bashkëpunimin ndërinstitucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP). Kështu është shprehur gadishmëria për inspektime të përbashkëta mbi tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe inspektorë të AMF-së do të trajnohen nga DPPPP. AMF do të shkëmbejë informacion me autoritetet e tjera mbikëqyrëse vendore dhe të huaja dhe këtë e ka vendosur edhe në projektin për disa ndryshime në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Gjithashtu, AMF raporton në mënyrë periodike pranë DPPPP për realizimin e objektivave.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, 2006 (Central European Free Trade Agreement, CEFTA)

Më 19 dhjetor 2006, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Serbia dhe Kombet e Bashkuara, Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK) në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të 1244, nënshkruan një marrëveshje për ndryshimin dhe zgjerimin të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 2006 (Central European Free Trade Agreement, CEFTA)

Pas proceseve të nevojshme të ratifikimit, CEFTA 2006 hyri në fuqi më 26 korrik 2007 për pesë nënshkruarit (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia dhe UNMIK/Kosovë), për Kroacinë, më 22 gusht 2007, për Serbinë, më 24 tetor 2007 dhe për Bosnjën dhe Hercegovinën, më 22 nëntor 2007. Shpejtësia me të cilën palët ratifikuan këtë marrëveshjeje ambicioze tregon rëndësinë e kësaj marrëveshjeje për zhvillimin ekonomik në rajon.

Objektivat kryesorë të kësaj marrëveshjeje të plotë janë, ndër të tjera, zgjerimi i tregtisë në mallra dhe shërbime dhe nxitja e investimeve me anë të rregullave të paanshme, të qëndrueshme dhe të parashikueshme, eliminimi i barrierave të tregtisë mes palëve, sigurimi i mbrojtjes së përshtatshme të të drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimi i dispozitave mbi çështjet e politikës moderne tregtare të tilla si rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Ajo gjithashtu përfshin procedura të qarta dhe efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe lehtëson krijimin gradual të zonës së tregtisë së lirë midis vendeve të BE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.



2.7 Marrëdhëniet me publikun dhe transparencja

AMF hartoi në shkurt të këtij viti Strategjinë e Komunikimit me median për periudhën 2012-2015. Strategjia synon ngritjen e shkallës së informimit të publikut për tregjet që Autoriteti mbikëqyr si një ndër objektivat kryesorë të tij. Strategjia synon gjithashtu edhe një edukim të vazhdueshëm financiar të publikut, edukim që është theksuar si domosdoshmëri edhe nga zhvillimet e fundit ekonomike në shkallë botërore.

Strategjia përcakton kryesisht median si një ndër mjetet kryesore për edukimin dhe rritjen e nivelit të njohurive të publikut për tregjet financiare, por pa lënë mënjanë edhe kanalet e tjera të komunikimit. Nismat apo grupet e aktiviteteve që veçohen në strategji janë përcaktuar specifikisht për grupe të veçanta të cilat AMF do t'i arrijë në komunikimin e saj.

Në zbatim të kësaj strategjie dhe të përvojave ndër vite të AMF-së, edhe gjatë vitit 2012 publikut i është ofruar informacion i gjerë në lidhje me tregjet financiare nën mbikëqyrje. Mediat e shkruara, kryesisht ato me tirazh më të lartë, kanë pasqyruar në mënyrë sistematike aktivitetin e AMF-së. Ndër tematikat më të pasqyruara në media kanë qenë ato që lidheshin me ndjeshmëritë e publikut për tarifat e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe përgjithësisht zhvillimet në tregun e sigurimeve; informacioni mbi pensionet private vullnetare; ecuria në tregun e letrave me vlerë. Këto janë shprehur në mbi 160 prezantime në gazetatat e përditshme si edhe mbi 50 dalje në televizionet me mbulim kombëtar dhe rajonal. Objekt i mbulimit mediatik kanë qenë edhe informacione të tjera nga AMF si ato për zhvillimet legjislative që lidhen me aktivitetin e AMF-së, pavarësinë e autoritetit rregullator të sektorit financiar, marrëveshjet e bashkëpunimit të AMF-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për kontrollin e pajisjes me policat e sigurimit të detyrueshëm.

Krahas komunikimit në media, AMF përdor një larmi formash dhe metodash për të arritur një komunikim sa më efektiv me publikun. Këtu mund të veçojmë komunikimin përmes faqes zyrtare të internetit, buletinet mujore informuese për të tre tregjet e mbikëqyrura, botimet periodike vjetore, fletëpalosjet, etj.

Publikimet periodike me karakter informativ dhe edukativ kanë synuar njohjen e konsumatorëve me tregjet financiare nën mbikëqyrje, mënyrën e funksionimit të tij. Gjatë vitit 2012 u botua Raporti Vjetor, Raporti i Mbikëqyrjes, Gjeografia e Sigurimeve, Buletini Zyrtar, si edhe fletëpalosje me informacione mbi tregjet financiare nën mbikëqyrje.

Në tetor 2012, AMF organizoi konferencën ndërkombëtare "Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar". Media vizive në vend e pasqyroi gjerësisht këtë konferencë edhe në transmetime të drejtpërdrejta televizive. Po kështu konferenca u

Botimet e AMF-së

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini zyrtar
- Fletëpalosje për tregjet nën mbikëqyrje

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku i AMF-së
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare

Botim i ri i AMF-së

- Material Diskutimi "Pavarësia e rezervuar për AMF-në"

pasqyrua me një artikull të gjerë në faqen në internet www.xprim.com. Kjo është një agjenci mediatike e specializuar në pasqyrimin e veprimtarive në tregun e sigurimeve dhe pensioneve private, e vendosur në Rumani, por fokusohet në zhvillimet në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Po kështu konferenca u pasqyrua edhe në faqet zyrtare në internet të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) <http://albania.usaid.gov> dhe Programi Partnerët për Stabilitet Financiar (PSF), www.pfsprogram.org.

Edhe gjatë vitit 2012 një vëmendje e veçantë ju kushtua faqes zyrtare të AMF-së www.amf.gov.al duke e


pasuruar atë me informacion të vlefshëm, të përditësuar me zhvillimet më të fundit të tregjeve. Këto informacione janë mjaft të vlefshme si për shoqëritë e sigurimit ashtu edhe për publikun si konsumator i këtyre shërbimeve. Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja zyrtare në internet e AMF-së jep të përditësuar edhe të gjithë informacionin mbi të gjithë vendimet e Bordit të AMF-së.

Në një seksion të veçantë faqja ka materiale për edukimin e konsumatorit. Ajo jep mundësi që konsumatori të kontaktojë në AMF për problemet dhe shqetësimet që mund ti krijohen në tregjet ku AMF vepron si rregullator dhe mbikëqyrës.



Takimi me median i Kryetares së AMF-së, Znj. Enkelelda Shehi, në Konferencën Ndërkombëtare "Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar".

Publikimi i projekteve ligjore në proces në faqen zyrtare të AMF-së, para miratimit të tyre, ka rezultuar një mënyrë efikase dhe transparente komunikimi, në mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjitha palët e interesit. Që prej publikimit të projekt ligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" në faqen zyrtare në internet të AMF-së gjatë vitit 2012, Autoriteti ka marrë komente për këtë ligj nga palët e interesit. AMF shqyrtoi me kujdes komentet e dërguara nga Shoqata e Siguruesve



të Shqipërisë për projektligjin dhe mjaft prej tyre u reflektuan në nene të veçanta të këtij projektligji.

AMF ka vijuar të informojë publikun nëpërmjet periodikut elektronik mujor, i cili përmban informacione të larmishme në lidhje me zhvillimet e sektorit financiar nën mbikëqyrje në Shqipëri, si dhe me zhvillimet dhe tendencat globale më të fundit të rregullimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Në rubrikën, edukimi i konsumatorit, kryesisht përfshihen punime mbi shërbimet dhe produktet financiare, të cilat janë nën juridiksionin e AMF-së. Po kështu një rubrikë e veçantë i kushtohet informacioneve dhe praktikave më të mira të përshtatura nga tregjet e ndryshme në rajon e më gjerë.

Raportet periodike statistikore e financiare, që AMF publikon, me periodicitet mujor, 3-mujor, 6-mujor dhe vjetor, japin një pamje të qartë të dinamikës së zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe plotësojnë nevojat për informacion për një numër të gjerë përdoruesish.

Kapitulli 3

Mbrojtja e Konsumatorit


Përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të konsumatorit, AMF realizon një ndër objektivat kryesore të saj, mbrojtjen e konsumatorit dhe interesave të tij. Për arritjen e këtij objekti, AMF ka përmirësuar në vazhdimësi procedurat dhe praktikën e trajtimit të ankesave, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore dhe rritjen e besimit tek roli i i saj.

Gjithashtu, AMF ndihmon konsumatorin duke ndërhyrë pranë subjekteve financiare nën mbikëqyrje për të korigjuar një gabim apo duke shpjeguar rrugën ligjore në mënyrën lehtësisht të kuptueshme. Aktet ligjore në fuqi detyrojnë edhe subjektet financiare t'i ofrojnë konsumatorit informacionin e përditësuar, në lidhje me produktet që ofrojnë, kushtet e kontratës, detyrimet e palëve, rastet dhe mënyrat e zgjidhjes së plotë apo të pjesshme të kontratës, përfitimet që rrjedhin nga kontratat, etj.

Informimi i konsumatorit me transparencë synon krijimin dhe rritjen e besueshmërinë në rolin dhe misionin e AMF-së në shërbim të tij. Ky informim realizohet si nëpërmjet medias vizive dhe asaj të shkruar. AMF në faqen zyrtare në internet i ofron çdo personi të siguruar mundësinë për të verifikuar nëpërmjet Qendrës Kombëtare të të dhënave të sigurimit të detyrueshëm MTPL, vlefshmërinë e policës së tij të sigurimit. Po kështu në këtë faqe gjendet dhe Sistemi GSRM, (Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë), i cili ka hapur një dritare që publiku të mund të njihet drejtpërdrejtë me zhvillimet e fundit të letrave me vlerë.


Një mjet tjetër efikas në mbrojtje të interesave të konsumatorit është vazhdimi i funksionimit pranë AMF-së, i njesisë së mbrojtjes konsumatore. Kjo njësi trajton ankesat për të gjitha rastet që paraqiten si për vonesat në trajtimin e dëmeve ashtu dhe për ankesa ndaj refuzimit apo masës së dëmshpërblimit, duke ndihmuar konsumatorin për zgjidhje të situatave në mënyrë sa më të efektshme. Procedurat e AMF-së fillojnë që me njohjen e praktikës së dëmit, sygjerimet ndaj shoqërisë së sigurimit për trajtim në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontaktet e vazhdueshme me shoqërinë e sigurimit për zgjidhje sa më optimale, institucionale të çështjes së ankimuar, etj.

Gjatë vitit 2012, kjo njësi ka trajtuar 51 ankesa në lidhje me funksionimin e sistemin e dëmshpërblimit që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, nga të cilat 46 janë zgjidhur, ndërsa 4 janë refuzuar për arsye se kanë rezultuar se ankesat nuk përmbanin shkaqe ligjore dhe një ankese është kthyer për plotësim dokumentacioni.




Grafik 10: Ankesat dhe zgjidhjet 2007-2012

(në numër)



Njësia për mbrojtjen e konsumatorit vepron si për konsumatorin e tregut të sigurimeve, të tregut të letrave me vlerë, ashtu edhe tregut të pensioneve private vullnetare.

Grafik 11: Mjetet e Autoritetit me qëllim mbrojtjen e konsumatorit



Shërbimi për konsumatorin

Sistemi telefonik në mbrojtje të konsumatorit, përfshin numrin fiks si dhe numrin jeshil, ku bëhet i mundur aksesimi i shërbimeve pa pagesë nga ana e konsumatorëve.

Gjatë vitit 2012, ky shërbim, nëpërmjet linjës telefonike ka pasur një numër të konsiderueshëm të telefonatave. Nëpërmjet këtij shërbimi konsumatori ka bërë pyetje kryesisht për produktet e ofruara nga shoqëritë e sigurimit apo ka paraqitur një ankesë në lidhje me ofrimin e këtyre produkteve.

PJESA II TREGJET E MBIKËQYRURA




II.1 Tregu i sigurimeve

Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2012, industria shqiptare e sigurimeve vazhdoi të njohë rritje të qëndrueshme krahasuar me një vit më parë. Edhe numri i shoqërive që kryejnë aktivitetin e sigurimit në Shqipëri u rit me licencimin e një tjetër shoqërie me aktivitet në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës. Kështu, në fund të vitit 2012 ushtronin aktivitetin e tyre 11 shoqëri sigurimi, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës, një shoqëri me veprimtari në sigurimet e Jetës dhe Jo-Jetës dhe një tjetër shoqëri me veprimtari në sigurimet e Jo-Jetës dhe Risigurimit.

Grafik 12: Ecuria e primeve dhe dëmeve në vite

(në mln. lekë)




Në vitin 2012 tregu i sigurimeve ka patur një rritje prej afro 8.94%⁷ të volumit të primeve të shkruara bruto, krahasuar kjo me një vit më parë. Primet e shkruara bruto për vitin 2012 kapën shifrën rreth 8.95 miliardë lekë. Rritja e tregut të sigurimeve për vitin 2012 është nxitur kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve vullnetare dhe veçanërisht nga sektori i Jo-Jetës, i cili zë 89.85% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.

Shënim: ⁷ Krahasimi është bërë me shifrat e Raporteve të Audituar të vitit 2011

Tabela 17: Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe ndryshimi, 2010-2012

Veprimtaria	Primet e shkruara bruto						Ndryshimi në %	
	(mln. lekë)			(mijë euro) ⁸			(në lekë)	
	2010	2011	2012	2010	2011	2012	2011/2010	2012/2011
Jeta	848	941	880	6,157	6,707	6,329	10.92	-6.48
Jo-Jeta	7,297	7,256	8,042	52,954	51,717	57,837	0.56	10.83
Risigurimi	55	18	28	401	131	202	-66.66	52.91
Total	8,200	8,215	8,950	59,511	58,555	64,369	0.18	8.94

Grafik 13: Struktura e tregut të sigurimeve, 2012



Dendësia e sigurimit⁹


Në vitin 2012, primi për frymë ishte mesatarisht 3,200 lekë (23.02 euro). Nga kjo shumë, 316 lekë është shpenzuar në sigurimin e Jetës dhe 2,885 në sigurimin e Jo-Jetës.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës gjatë vitit 2012 shënoi rritje të primeve të shkruara bruto me rreth 10.83%, krahasuar me vitin 2011, duke arritur një vlerë prej afro 8.04 miliardë lekë.


⁸ Kursi mesatar vjetor i këmbimit në Euro sipas viteve përkatëse, marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë, www.bankofalbania.org (Viti 2010, 1 euro = 137.80 ; Viti 2011, 1 euro = 140.30; Viti 2012, 1 euro = 139.04 lekë)

⁹ Popullsia 01.01.2013, marrë nga faqja zyrtare e INSTAT, www.instat.gov.al




Grafik 14: Primet e shkruara bruto, Jo-Jeta, 2003-2012

(mln. lekë)




Grafik 15: Struktura e tregut të Jo-Jetës, 2012



Sigurimi motorik solli me më shumë se 63.67% e të totalit të ardhurave të Jo-Jetës, duke zënë peshën kryesore në këtë treg, ku edhe konkurrenca vazhdon të jetë e fortë. Në vitin 2012, primet e shkruara bruto në sigurimin motorik arritën vlerën 5.12 miliardë lekë, kundrejt 4.35 miliardë lekë në vitin 2011. Efekti rritës prej 17.60% i primeve të sigurimit motorik ka ardhur kryesisht nga produkti MTPL e brendshme.

Grafik 16: Sigurimi motorik, primet e shkruara bruto 2003-2012

(mln. lekë)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2012, sigurimet e detyrueshme motorike (të përgjegjësishë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta) dominuan strukturën e tregut, duke sjellë rreth 51.13% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit *MTPL e brendshme*, në vitin 2012, arritën në rreth 3.37 miliardë lekë, ose rreth 52.81% më shumë se në vitin 2011.

Në vitin 2012, primet e shkruara bruto të portofolit *Kartoni Jeshil* ishin rreth 0.69 miliardë lekë ose rreth 37.56% më pak se në vitin 2011.


Në vitin 2012, primet e shkruara bruto të portofolit *Sigurimi Kufitar* ishin rreth 0.52 miliardë lekë ose rreth 23.85% më shumë se në vitin 2011.

Sigurimet vullnetare¹⁰

Në vitin 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në rreth 4.37 miliardë lekë, ose 2.58% më pak se të ardhurat e një viti më parë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës me të ardhura rreth 3.46 miliardë lekë, portofolet me peshë specifike më të lartë janë zjarri dhe dëmtimet në pronë me rreth 49.27%, të pasuara nga *sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit* me rreth 17.93% dhe *sigurimi Kasko* me rreth 15.66%.


Shënim: ¹⁰ Në të ardhurat nga sigurimet vullnetare është përfshirë dhe veprimtaria e risigurimit.



Në portofolin *sigurimi nga zjarri dhe dëmtimet në pronë*, gjatë vitit 2012, ndihet një rritje prej 49.87% e volumit¹¹ të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli, krahasuar me vitin 2011.

Të ardhurat nga primet e shkruata bruto në sigurimet e *Aksidenteve dhe Shëndetit*, gjatë vitit 2012, arritën në rreth 0.62 miliardë lekë, duke shënuar ulje prej 28.95% në krahasim me vitin 2011. Peshën më të madhe të të ardhurave të këtij grupi e mbajtën *Sigurimet e Aksidenteve* me rreth 62.30% të totalit.


Grafik 17: Zhvillimi i tregut të sigurimeve të detyrueshme e vullnetare, 2003-2012 (mln. lekë)



Shënim: ¹¹ Bazuar në Udhëzimin Nr. 140, datë 26.09.2012 "Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimitit e risigurimitit", në portofolin "Sigurimi nga Zjarri dhe Dëmtimet në Pronë" raportohen edhe "Sigurimi i objekteve të ndërtimit (CAR)" dhe "Sigurimi nga ngritja e makinerive (EAR)" që në vitet e mëparshme raportohesh në portofin "Përgjegjësitë e Përgjithshme".

Grafik 18: Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës, 2008-2012

(mln. lekë)




Primet e sigurimit të Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës në vitin 2012, krahasuar me një vit më parë patën një ulje prej 6.43%, duke arritur një vlerë prej 0.88 miliardë lekë. Faktori që ka influencuar më shumë në uljen e sigurimit të Jetës ka qenë ulja e primeve të shkruara bruto në sigurimin *Jetë Debitori* dhe *Jetë në Grup*. Primet e shkruara bruto për portofolin e sigurimit *Jetë Debitori* janë 8.67% më pak se në vitin 2011.

Grafik 19: Primet e shkruara bruto, Jeta, 2003-2012

(mln. lekë)






Shpërndarja gjeografike e sigurimeve

Duke i hedhur një vështrim primit të shkruar bruto sipas shpërndarjes gjeografike, të bie në sy një përqëndrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha.


Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2012 është rreth 3,200.41 lekë për frymë me një rritje prej 263.23 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura e Tiranës me 7,388.64 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga prefektura Gjirokastrë me 3,648.67 lekë për frymë dhe më tej Durrësi dhe Vlora përkatësisht me 2,622.72 lekë për frymë dhe 1,927.90 lekë për frymë.

Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave




Grafik 20: Dëmet e paguara sipas prefekturave



Dëmet


Gjatë vitit 2012, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 2.81 miliardë lekë dëme¹², ose rreth 26.00% më shumë se në vitin 2011. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me 2.12 miliardë lekë, apo 75.43% të totalit.

Grafik 21: Struktura e dëmeve të paguara, 2012




Grafik 22: Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit në vite

(mln. lekë)




Shënim: ¹² Dëme të paguara bruto.




Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2012, tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës u nda ndërmjet shoqërive të sigurimeve Sigal Unica Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Interalbani Vienna Insurance Group, Eurosig, Intersig Vienna Insurance Group, Albsig, Atlantik, Insig dhe Ansig. Sigal Unica Group Austria udhëhoqi tregun me 30.34% të primeve të shkruara bruto.

Grafik 23: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, 2012



Grafik 24: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jetës, 2012



Gjatë vitit 2012, aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal Life Uniqa Group Austria, Insig dhe SiCRED. Sigal Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me rreth 51.19% të primeve të shkruara bruto.

Risigurimet

Gjatë vitit 2012, shoqëritë e sigurimit kanë kontraktuar rreziqe të cilat i përkasin produkteve të sigurimit vullnetar, sigurimit të detyrueshëm motorik për automjetet si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil si dhe sigurimit të përgjegjësisë ligjore të tregtuesve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

AMF ka ushtruar mbikëqyrje të vazhdueshme në identifikimin dhe vlerësimin e riskut sipas aktivitetit të biznesit si dhe ka monitoruar vazhdimisht mënyrën e administrimit dhe transferimit të riskut në shoqëritë e sigurimit me anë të inspektimeve *on-site* dhe *off-site*. Shoqëritë përdorin kapitalet e nevojshme dhe kryejnë transferim të rrezikut për portofole të veçanta sigurimi, në funksion të zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha. Ky transferim realizohet nëpërmjet bashkësigurimit, kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi dhe mbulimit me risigurim fakultativ në kontrata të veçanta.

Marrëveshjet risiguroese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë si të formës jo proporcionale të tipit *Excess of Loss*, ashtu edhe të formës proporcionale të tipit *Quota Share* e *Surplus*.


Ndërkohë, në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit *Surplus* e të tipit *Quota Share*.

AMF ka monitoruar marrëveshjet risiguroese dhe kontratat fakultative të risigurimit në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risiguroesve.

Primet e ceduara në risigurim për periudhën e 31.12.2012 rezultojnë:

- Për sigurimin e Jo-Jetës në vlerën mbi 1,865.13 milionë lekë ose 23.19% e primeve të shkruara bruto;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën mbi 38.35 milionë lekë ose 4.36% e primeve të shkruara bruto;
- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën mbi 1,903.48 milionë lekë ose 21.33% e primeve të shkruara bruto.

Më shumë se 90% e partnerëve risiguroes të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BBB- nga Standard & Poors, nga ku mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A. Ndër pjesëmarrësit kryesorë në këto programe risigurimi mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Scor, Lloyd's Syndicates, VIG Re, etj.



Krijimi dhe mbajtja e përshtatshme e provigjoneve teknike e matematike të sigurimit

Një çështje shumë e rëndësishme për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes financiare të shoqërive të sigurimit janë analizat periodike lidhur me mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike e matematike. Lidhur me këtë, AMF ka monitoruar me kujdes përlogaritjet e provigjoneve teknike e matematike në çdo tremujor, bazuar në ligjin e sigurimeve dhe rregulloret përkatëse.

Niveli i provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit

Me liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik në gusht të vitit 2011, edhe gjatë vitit 2012 tregu shqiptar i sigurimeve ka dëshmuar luhatje të çmimeve, kryesisht me tendencë uljeje. Duke u mbështetur në eksperiencën e tregut të sigurimeve në Shqipëri, rezultoi se tarifat e propozuara jepnin sinjalin për ulje të likuiditetit për shoqëritë e sigurimeve si dhe rrezikonin përmbushjen e rregullave të menaxhimit të riskut në përputhje me Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”. AMF ka monitoruar në vazhdimësi dhe mbi baza ditore situatën në tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike.

Pavarësisht tarifave të liberalizuara të primit të sigurimit të detyrueshëm, shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervat teknike dhe provigjonet, jo më pak se niveli i rezervave teknike dhe provigjoneve, të përcaktuara me rregullore nga AMF. Sipas Rregullores nr. 110, datë 28.07.2011, ndryshuar, për “Përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, Autoriteti përcakton e njofton shoqëritë e sigurimit për primin e rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, mbi bazën e të cilit llogaritjet provigjoni teknik i primit të pafituar.

Llogaritja e provigjonit teknik i dëmeve dhe i primeve kryhet sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 9 datë 08.02.2007 të AMF-së “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimit të Jo-Jetës”, e ndryshuar. Ndërsa për kontratat e sigurimit të Jetës llogaritjet bazohen në Rregulloren nr. 8, datë 08.02.2007 të AMF-së “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike”.

Me ndryshimin e Rregullores nr. 9, datë 08.02.2007, ndryshuar, të AMF-së “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimit të Jo-Jetës”, llogaritja e provigjonit teknik i dëmeve në proces gjyqësor, për të cilat ka vendimeve nga gjykata, pavarësisht shkallës në të cilën ndodhet procesi gjyqësor, aktuari i shoqërisë së sigurimit duhet të marrë për bazë vlerën e dëmeve të caktuara nga vendimet e gjykatave.

Sipas Rregullores nr. 110, datë 28.07.2011, ndryshuar, shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Primi i sigurimit përbëhet nga elementët e përcaktuara në nenin 99 të Ligjit 9267, datë 29.07.2004, dhe shoqëritë e sigurimit mund t'i ndryshojnë, por jo më shpesh se një herë në 3 muaj.

Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin 10 ditë përpara fillimit të zbatimit të tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit dhe së bashku me njoftimin depoziton në AMF bazat teknike të përdorura, metodikën e përdorur për llogaritjen e primit të sigurimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm, si dhe materialet mbështetëse.


Shoqëria publikon primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Sipas Rregullores nr. 110, datë 28.07.2011, ndryshuar për "Përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", roli i komitetit të aktuarëve i ka kaluar shoqatës së aktuarëve. Shoqata e aktualëve, me kërkesë të AMF-së mund të llogarisë primin e rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm si dhe bashkëpunon me Autoritetin dhe ka rol këshillues.

Të punësuarit në tregun e sigurimeve

Në vitin 2012, numri i të punësuarve me kohë të plotë në industrinë e sigurimeve ishte mesatarisht 1,320 me një tendencë rritjeje prej afro 18% krahasuar me vitin 2011.

Grafik 25: Numri i të punësuarve në industrinë e sigurimeve 2009 - 2012




II.2 Tregu i letrave me vlerë

Viti 2012 shënoi zhvillime pozitive në tregun e letrave me vlerë, kryesisht me zhvillimin e tregut të fondeve të investimit. Licencimi i shoqërisë së parë administruese në këtë treg u pasua nga një dinamikë e lartë e rritjes së këtij segmenti të tregut të letrave me vlerë, i cili krahas tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), përbën segmentin më aktiv në tregun e letrave me vlerë në Shqipëri, ndërsa tregu i aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar. Ecuria e rezultateve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë mund të ndiqet me bazë ditore nëpërmjet faqes së internetit të AMF-së, në rubrikën GSRM.

Fondet e Investimeve

Aktiviteti i fondeve të investimeve kryhet në përputhje me Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive". Në mbështetje të këtij ligji, AMF licencoi në datë 13/12/2011, shoqërinë Raiffeisen Invest, shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.



Oëllimi i fondeve të investimit të licencuar deri tani nga AMF është ofrimi i një kthimi nga investimi, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetin e nevojshëm. Ky investim bëhet me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit.

Në datën 1 shkurt 2012 filloi veprimtarinë e tij fondi i investimit Raiffeisen Prestigj, i administruar nga Shoqëria “Raiffeisen Invest”-shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. Gjatë vitit 2012 u vërejt një dinamikë zhvillimi shumë e shpejtë e aktivitetit në fondet e investimeve.

Shoqëria “Raiffeisen Invest” sh.a. aktualisht administron dy fonde investimesh “Fondin e Investimeve Raiffeisen Prestigj”, i licencuar më datë 13.12.2011 dhe “Fondin Raiffeisen Invest Euro”, i licencuar më datë 26.09.2012.

Vlera neto e asetëve të fondeve të investimit për periudhën 31.12.2012 arriti në 16.01 miliardë lekë dhe dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione të Oeverisë, të cilat përbëjnë 71.61% të asetëve të fondeve.

Tabelë 18: Tregues të numrit të fondeve të investimit dhe anëtarëve 31.12.2012

<i>Përshkrimi</i>	<i>Nr.</i>	<i>vlera (mijë lekë)</i>	<i>Në %</i>
Numri i shoqërive administruese të fondeve të investimeve	1		
Numri i fondeve të investimit	2		
Numri i anëtarëve në fond	10,962	16,007,895.27	100.00
<i>Individë</i>	10,960	15,991,483.66	99.90
<i>Persona juridikë</i>	2	16,411.61	0.10

Tabelë 19: Tregues për vlerat e kuotave të fondeve të investimeve

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera fillestare e vlerës neto të asetëve për kuotë</i>	<i>Vlera neto e asetëve për kuotë 31.12.2012</i>	<i>Norma e kthimit në bazë vjetore (%)</i>
Raiffeisen Prestigj	1,000 lekë ¹³	1,061.72 lekë	7.39
Raiffeisen Invest EURO ¹⁴	14,000 ¹⁵	14,069.20	7.19

Shënim: ¹³ Vlera fillestare në 31.03.2012

¹⁴ Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin 1 euro = 140 lekë

¹⁵ Vlera fillestare në 22.11.2012

Tabelë 20: Tregues të detajuar të aseteve të fondeve të investimeve


Përshkrimi	31.03.2012 mijë lekë	31.12.2012 mijë lekë	Ndryshimi në %	Pjesa ndaj totalit në %	
				31.03.2012	31.12.2012
Asetet neto të fondit	1,408,154.99	16,007,895.49	1,036.80		
Totali i aseteve të fondit	1,416,546.71	16,061,312.30	1,033.84	100.00	100.00
<i>nga të cilat:</i>					
Obligacione qeveritare	537,854.35	11,502,271.63	2,038.55	37.97	71.61
Bono thesari	669,330.78	2,074,594.04	209.95	47.25	12.92
Mjete monetare	205,961.22	2,138,096.01	938.11	14.54	13.31
Asete të tjera	3,400.36	346,350.63	10,085.72	0.24	2.16
Totali i detyrimeve të fondit	8,391.71	53,416.81	536.54	0.59	0.33

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2012 u dominua në masën 77.95% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 22.05% nga instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 97.05% e të gjitha transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari. Transaksionet "Blerje në tregun primar" dhe "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2012. Ato arrijnë përkatësisht në masën 44.04% dhe 27.71% kundrejt volumit të përgjithshëm të transaksioneve. Investitorët individualë, dominojnë në këtë treg duke kryer rreth 72.44% të të gjitha transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Tabelë 21: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (mln. lekë)		Ndryshimi (në%) `12/`11-1
	2011	2012	
A Blerje në tregun primar	8,850	19,991	125.89
Individë	7,260	10,896	50.09
Persona juridikë	1,590	9,095	472.00
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	6,935	7,066	1.90
Individë	5,781	5,873	1.59
Persona juridikë	1,153	1,193	3.46
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	3,108	5,663	82.23
Individë	1,687	5,021	197.67
Persona juridikë	1,421	642	(54.81)
D Vendosje e bonos si kolateral	53	97	85.10
Individë	36	54	51.81
Persona juridikë	17	43	155.35
E Shlyerje e vlerës nominale në maturim	13,473	12,578	(6.64)
Individë	11,449	11,041	(3.56)
Persona juridikë	2,024	1,537	(24.05)



Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë)

Viti 2012 shënoi vitin e gjashtë të menaxhimit nga AMF në mënyrë të suksesshme të platformës GSRM. Gjatë këtij viti, kjo platformë u zgjerua me një operator të ri, Banka Societe Generale Albania, duke e çuar numrin e operatorëve të licencuar për të ushtruar veprimtarinë në këtë treg në 10 (dhjetë).

Kjo platformë vazhdon të funksionojë me qëllim që të sigurojë rritjen e transparencës në lidhje me kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve. Platforma GSRM jep një informacion të plotë dhe të përditësuar për publikun dhe investitorët institucionale në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë.

Gjatë vitit 2012, në platformën GSRM janë kryer 19,990 klikime duke zënë rreth 15.08% të të gjithë vizitave në faqen zyrtare të AMF-së. Gjatë këtij viti është vënë re një interes shumë i lartë i vizitorëve, në krahasim me vitin 2011 duke pasur një rritje prej 190.47% e cila tregon interesimin gjithnjë e në rritje të publikut për këtë platformë. Në këtë platformë, përfshihet dhe një bazë e të dhënave historike, e cila i vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike. Përmirësimi në vazhdimësi i kësaj rubrike me elementë të rinj, do të vijojë të mbetet në fokusin e AMF-së, në mënyrë që t'i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të tregut dhe publikut për informacion sa më të plotë e të përditësuar.

Tregu i kapitaleve

AMF, si autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të kapitalit është shprehur vazhdimisht për domosdoshmërinë e zhvillimit të këtij tregu dhe rolin e tij në zhvillimin e ekonomisë.

Gjatë vitit 2012, Autoriteti dhe Bursa e Tiranës ishin pjesë e Programit Partnerët për Stabilitetin Financiar (PFS) të USAID-it. Roli i PFS është mbështetja e zhvillimit të sektorit financiar, ku tregu i kapitalit përfaqëson një nga fushat ku do të drejtohet edhe vëmendja. PFS mbështet bashkëpunimin e Autoriteteve rregullatore dhe Bursave të rajonit për zhvillimin e tregut të kapitalit. Në kuadrin e këtij Programi, Bursa e Tiranës u bë pjesë e Marrëveshjes së Platformës për veprim të përbashkët me Bursat e Evropës Juglindore. Krijimi i një platforme të përbashkët tregtimi do t'u japë mundësi investitorëve të tregtojnë letra me vlerë të listuara në Bursat e këtyre vendeve.

Ndërkohë, Bursa e Tiranës ka vazhduar përpjekjet për ndërgjegjësimin e biznesit vendas për avantazhet që sjell tregu i kapitaleve si një alternativë konkurruese për sigurimin e fondeve financiare, si dhe në drejtim të edukimit të investitorëve mbi alternativat e investimit që krijon pjesëmarrja në tregun e kapitaleve.

Regjistrimi i aksioneve

Regjistrimi i aksioneve, të cilat shiten dhe blihen mes individëve jashtë tregut të organizuar, regjistrohen pranë shoqërisë "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve", QRA, shoqëri e licencuar nga AMF për mbajtjen e regjistrit të aksioneve. Në fund të vitit 2012, QRA numëronte 100 shoqëri aksionare të regjistruara.

Tabelë 22: Statistika mbi transaksionet e regjistruara në QRA për vitin 2012

<i>Treguesit</i>	<i>Statistika</i>
1. Nr. total i shoqërive aksionere të regjistruara pranë QRA-së	100
2. Nr. total i aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së	471,825,721
3. Nr. total i shoqërive, aksionet e të cilave janë tregtuar	34
4. Nr. total i transaksioneve të kryera gjatë vitit 2012	179
5. Nr. total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2012	195,200
6. Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2012	0.04%

Burimi: Qendra e Regjistrimit të Aksioneve

Gjatë vitit 2012, QRA ka reflektuar në regjistrat e aksioneve të shoqërive aksionare 179 transaksione, krahasuar me 263 transaksione të kryera në vitin 2011. Numri i aksioneve të tregtuara jashtë tregut të organizuar gjatë vitit 2012, përbën rreth 0.04% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së, çka tregon se volumi i transaksioneve është i ulët.

II.3 Tregu i pensioneve private vullnetare

Gjatë vitit 2012 në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2012 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 283.01 milion lekë dhe me një rritje prej afro 128.27 milion lekë (82.89%). E shprehur në euro, totali i asetëve nën menaxhim është 2.03 milion euro¹⁶. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në fund të vitit 2012 ishte 7,281 anëtarë duke shënuar rritje prej 15.66% krahasuar me fundin e vitit 2011.

Tabela 23: Tregues të fondeve të pensioneve

(31.12.2012)

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (%)</i>
<i>Periudha</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	
Asetet neto të FP	154.74	283.01	82.89

Shënim: ¹⁶ Kursi zyrtar i këmbimit ("fiksi") 31.12.2012 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 139.5 lekë






Tabela 24: Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve (31.12.2012)

<i>Fond Pensioni</i>	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>	<i>Asete Neto (mln. lekë)</i>
SIGAL	3,045	134.23
RAIFFEISEN	2,513	113.91
SiCRED PENSION	1,723	34.87
TOTAL	7,281	283.01

Grafik 26: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 31.12.2012



Grafik 27: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 31.12.2012



Sfidat dhe prioritetet e AMF-së

Objektivat e AMF-së janë të natyrës afatmesme dhe vit pas viti kryhen detyra e zbatohen projekte, të cilat i shërbejnë pëmbushjes së tyre. Rezultatet e arritura gjatë vitit 2012 kanë shërbyer si një bazë e mirë për të vijuar më tej në lidhje me pëmbushjen e objektivave si më poshtë:

- **Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor e rregullativ;**
- **Rritja e cilësisë dhe kapaciteteve të procesit mbikëqyrës;**
- **Promovimi dhe ruajtja e stabilitetit të tregjeve financiare;**
- **Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik;**
- **Zhvillimi teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës.**

Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor e rregullativ është një objektiv afatgjatë i AMF-së, i cili buron nga:


- përafrimi i kuadrit ligjor e rregullativ me direktivat e BE-së, në kuadër të procesit të integritetit të vendit në BE;
- përafrimi me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve financiare;
- nevojat e brendshme të tregjeve financiare dhe specifikat e tyre.

Vëmendja gjatë vitit 2013 do të përqendrohet në përmirësimet e nevojshme të ligjit për sigurimin e detyrueshëm; ndjekjen deri në miratim të projektligjit për veprimtarinë e sigurimeve dhe të risigurimeve dhe të projektligjit për disa ndryshime e plotësime në ligjin për AMF; si dhe në përafrimin e plotë të ligjit për fondet e pensionit vullnetar me direktivat e BE, me asistencën e Bankës Botërore. Miratimi i këtij kuadri ligjor do të shoqërohet me një punë të konsiderueshme në hartimin e akteve përkatëse rregullative dhe të vlerësimit të përputhshmërisë me direktivat e BE-së.

Në kuadër të angazhimeve që AMF ka marrë nga misioni i Bankës Botërore, për projektin e stabilitetit financiar dhe administrimin e borxhit, gjatë vitit 2013 do të punohet për hartimin e rregullores për funksionimin e tregjeve mbi banak (OTC) si edhe të kodit të etikës për tregtarët e OTC.

Rritja e cilësisë dhe kapaciteteve të procesit mbikëqyrës përbën një objektiv themelor të AMF. AMF do të vazhdojë të ndjekë me përparësi gjatë vitit 2013 drejtimet e identifikuara strategjike, që synojnë modernizimin e mbikëqyrjes dhe përafrimin me praktikën evropiane. Konkretisht gjatë vitit 2013, prioritet do të jetë:

- Zhvillimi i mëtejshëm dhe shtrirja e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për segmentet e tjera të tregjeve financiare.
Sistemi i Menaxhimit të Informacionit ka qenë një ndër nismat dhe objektivat afatmesëm më të rëndësishëm të viteve të fundit, i cili është realizuar plotësisht gjatë vitit 2012, me



hartimin e manualit të raportimit për tregun e sigurimeve. Tashmë AMF ka një platformë moderne të raportimit financiar, plotësisht funksionale për tregun e sigurimeve, në sajë të një pune 5 vjeçare. Pavarësisht realizimit të këtij objekti afatmesëm, AMF do të synojë të shtrijë këtë platformë moderne raportimi edhe për segmentet e tjera të tregjeve financiare që AMF mbikëqyr. Konkretisht gjatë vitit 2013 do të synohet:

- Futja e firmës elektronike si risi e platformës së raportimit, me qëllim eliminimin gradual të raportimit në letër;
 - Ndjekja e Planit Strategjik të Zbatimit të metodologjisë me fokus riskun për tregun e sigurimeve, duke zhvilluar në vazhdimësi raporte të dedikuara për mbikëqyrjen;
 - Fillimi i ndërtimit të formave për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë dhe testimi i tyre;
- Mbikëqyrja efektive për tregun e sigurimeve me fokus riskun.
Ky objektivi afatmesëm është zyrtarizuar në Tetor të vitit 2011, me miratimin nga Bordi i AMF i Planit Strategjik të Zbatimit të metodologjisë me fokus riskun për tregun e sigurimeve. Objektivat kryesorë për vitin 2013 do të jenë:
- Futja e disa elementëve të mbikëqyrjes me fokus riskun në proceset mbikëqyrëse dhe inspektimet në vend në shoqëritë e sigurimit, me qëllim ndërtimin e një baze të dhënash, që do të mundësojë zbatimin gradual të metodologjisë së re. Aprovimi i ligjit për sigurimet gjatë 2013 është tepër i rëndësishëm, në mbështetje të këtij objekti;
 - Rritja e vazhdueshme e njohurive dhe kapaciteteve të punonjësve në lidhje me mbikëqyrjen me fokus risku nëpërmjet trajnimeve të dedikuara.
- Rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse në tregjet e letrave me vlerë dhe pensione private vullnetare.

Dinamika e lartë e zhvillimit të segmenteve të tjera të tregjeve financiare, që AMF mbikëqyr, veçanërisht të tregut të fondeve të investimit, ka bërë që AMF t'i kushtojë rëndësinë e duhur rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve dhe optimizimit të burimeve të brendshme. Gjatë vitit 2013 do të synohen projekte të dedikuara për specifikat e mbikëqyrjes së këtij tregu dhe do të konsolidohen marrëdhënie institucionale me rregullatorë të tregjeve të zhvilluara, me qëllim marrjen dhe zbatimin e praktikave më të mira.

Promovimi dhe ruajtja e stabilitetit të tregjeve financiare përbën një tjetër objektivi strategjik, që AMF do të ketë si prioritet në vitet në vazhdim. Ndër veprimtaritë kryesore që do të mbështesin arritjen e këtij objekti gjatë vitit 2013 veçojmë:


- Hartimin e strategjisë së zhvillimit të tregut të letrave me vlerë;
Promovimi i tregjeve financiare është një objektivi strategjik i AMF, krahas mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare. Gjatë vitit 2013, AMF me asistencën e FSVC do të ndërtojë një strategji të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, duke u fokusuar në:

- Vlerësimin e kuadrit rregullues legjislativ;
 - Përcaktimin e nivelit aktual të zhvillimit dhe faktorëve kryesorë që e influencojnë atë;
 - Identifikimin e barrierave të mundshme dhe mundësive për zhvillim më tej të këtij tregu;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për pensionet private vullnetare;
Nëpërmjet instrumenteve të asistencës teknike që AMF përfton nga organizmat ndërkombëtarë, gjatë vitit 2013 një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe tregut të pensioneve private vullnetare, kryesisht rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet që sjell kjo skemë për ta. AMF së bashku me aktorët e tjerë të këtij tregu do të punojnë nën drejtimin e misionit të ekspertëve nga Komuniteti Evropian, për të identifikuar drejtimet kryesore dhe koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta për të promovuar këtë treg, i cili është ende në një fazë të hershme zhvillimi.
 - Konceptimi i një plani të posaçëm veprimi në situata të jashtëzakonshme.
Hartimi i këtij plani vjen si angazhim që AMF ka marrë të realizojë gjatë vitit 2013, në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar. Ky plan strategjik do të jetë pjesë e një plani kombëtar që do të koordinojë veprimet e institucioneve (konkretisht Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, AMF dhe ASD) në situata të mundshme krizash, që mund të prekin tregjet financiare.

Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik përbën një nga sfidat kryesore, me të cilat AMF po përballet, në kushtet e heqjes me ligj të regjimit të tarifave fikse në sigurimin e detyrueshëm motorik. Me asistencën e Bankës Botërore dhe financim të "First Initiative", në shtator të vitit 2011, filloi zyrtarisht projekti që do të asistojë AMF në orientimin e drejtë të procesit të liberalizimit. Gjatë vitit 2012 përfundoi hartimi i raporteve, që do të përcaktojnë strategjinë e mbikëqyrjes dhe të tarifimit të portofolit të sigurimit të detyrueshëm motorik në Shqipëri. Në të njëjtën kohë AMF ka punuar për të projektuar të gjitha zhvillimet e teknologjisë së informacionit, që përbëjnë infrastrukturën mbështetëse për zbatimin e strategjisë, në vitet në vazhdim.

Gjatë vitit 2013, do të punohet në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të projektit, kryesisht në drejtimet e mëposhtme:

- Zhvillimi i proceseve drejt tarifimit me bazë riskun të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Përafrimi i kuadrit aktual ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së;
- Rritja e kapaciteteve aktuariale në funksion të provigjonimit të kujdesshëm dhe tarifimit me bazë risku;
- Zhvillimet në sistemet e teknologjisë së informacionit në mbështetje të procesit të tarifimit me bazë risku dhe provigjonimit të kujdesshëm.




Zhvillimi teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës përmban një sërë detyrash ambicioze duke patur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion.

Në kuadër të zbatimit të sistemit Bonus-Malus në linjë me strategjinë e liberalizimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, për vitin 2013 do të punohet në disa drejtime:

- Ndryshime në Regjistrin Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike. Gjatë vitit 2013 do të mundësohet shfaqja automatike tek agjentët e shitjes vetëm e të dhënave kryesore të mjeteve motorike, të pronarëve të tyre dhe të kategorizimit të riskut. Kjo do të bëhet efektive edhe në sajë të bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Transportit, nëpërmjet lidhjes në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor. Në pjesën e parë të vitit 2013 do të përfundojnë ndryshimet e duhura, që japin mundësinë e marrjes në kohë reale për çdo policë siguri, të të dhënave mbi mjetin, pronarin, dhe elementet bazë të Çertifikates Bonus-Malus për secilin nga drejtuesit e mjetit;
- Projektimi i ndërfaqes së përdorimit për Byronë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS) me qëllim administrimin e policave dhe saktësimin e lëshimit të tyre. Ka përfunduar faza e studimit të projektit, por zbatimi i tij është skeduar në vitet e ardhshme.
- Të dhënat e Regjistrit Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike, tashmë shërbejnë dhe për kontrollin në kohë reale nga institucionet në bashkëpunim, si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet integritit të kontrollit të vlefshmërisë së policave me sistemin e kontrollit online të vendosur në qendrat operative “eGjoba”. Ky projekt është realizuar dhe është në funksionim nga nëntori 2012. Gjatë vitit 2013 synohet të realizohet shfaqja e këtyre rezultateve nëpërmjet ‘Portalit të Shërbimeve për Shoqëritë e Sigurimit’.
- Gjatë vitit 2012 janë realizuar një sërë përmirësimesh në Regjistrin e Dëmeve, si funksione në shërbim të shoqërive të sigurimit, raporte në shërbim të Autoritetit dhe funksione në shërbim të mirëmbajtjes së tij. Gjatë vitit 2013, do të bëhet e mundur shfaqja e tyre nëpërmjet ‘Portalit të Shërbimeve për Shoqëritë e Sigurimit’, ku një ndër shërbimet do të jetë shfaqja e elementëve bazë të Çertifikatës Bonus Malus. Kjo çertifikatë do të japë mundësinë e kategorizimit të riskut, bazuar në historikun e policave të sigurimit dhe të dëmeve.
- Gjatë vitit 2013 do të punohet për zgjerimin e mëtejshëm të “Sistemit SMS të mbështetjes së Konsumatorëve”. Aktualisht sistemi mbi baza vullnetare mundëson kontrollin dhe rikujtesën për përfundimin e periudhës së sigurimit. Në kuadër të bashkëpunimit me DPShTRr-në, gjatë vitit 2012 është mundësuar marrja e të dhënave për vlefshmërinë e taksave. Gjatë vitit 2013, për të mundësuar lajmërimin e automatizuar disa ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së taksave të qarkullimit dhe kolaudimit, do të bashkëpunohet dhe më tej me DPShTRr. Në bashkëpunim dhe me Policinë e Shtetit, gjatë kontrollit të policës dhe taksave të qarkullimit, do të jepet me SMS dhe numri i gjobave pezull.

SHTOJCA A

Struktura organizative e AMF-së



Të Përgjithshme

SHTOJCA B

Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin financiar nën mbikëqyrjen e AMF-së




Referenca	Emërtimi	Përshkrimi
Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006	"Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"	Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si institucioni i vetëm kompetent për licencimin e subjekteve në fushën financiare të sigurimeve, letrave me vlerë, pensioneve private vullnetare dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së këtij tregu.
Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009	"Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore"	Ligji për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore, zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve. Ligji zbatohet për obligacionet: a) e shoqërisë aksionare, me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë; b) e qeverisë vendore. Ky ligj nuk zbatohet në rastet e obligacioneve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë apo të Bankës së Shqipërisë.
Rregullore nr. 177, datë 13.12.2011	"Mbi organizimin e veprimtarisë kërkimore në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"	Rregulloja ka për objekt të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin e veprimtarisë kërkimore të AMF-së, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të çdo individi dhe njësie që angazhohet në këtë veprimtari.
Rregullore nr. 119, datë 19.09.2011	"Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm"	Rregulloja ka për qëllim të promovojë një kulturë etike në ushtrimin e auditimit të brendshëm.
Rregullore nr. 118, datë 19.09.2011	"Karta e auditimit të brendshëm"	Rregulloja përcakton misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm në Autoritet, të përcaktuara në përkufizimin, standardet ndër-kombëtare dhe kodin e etikës, që drejtojnë praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.
Rregullore nr. 83, datë 29.06.2011	"Për marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"	Rregulloja ka për qëllim përcaktimin e rregullave që disiplinon mënyrën e përcaktimit dhe masën e shpërbërimit dhe shpenzimeve për punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
Rregullore nr. 56, datë 30.03.2011	"Për funksionimin dhe administrimin e ambienteve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare"	Rregulloja ka për objekt përcaktimin e rregullave për funksionimin, administrimin, sigurinë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës dhe pajisjeve në AMF.
Rregullore nr. 37/2, datë 23.02.2011	"Kodi i Etikës në AMF"	Kodi i Etikës ka si qëllim që të shërbejë si udhëzues për të gjithë punonjësit e AMF-së lidhur me veprimet e përditshme apo me vendimmarrjen në përputhje me misionin, parimet drejtuese dhe vlerat e punonjësve. Kodi i Etikës shërben si një urë lidhëse ndërmjet integritetit personal e profesional në veprimet e përditshme të punonjësve dhe shpreh angazhimin e tyre ndaj Misionit të Autoritetit.
Rregullore nr. 37/1, datë 23.02.2011	"Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në AMF"	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për kushtet, procedurat, të drejtat dhe detyrimet, e pranimit, fillimit, vazhdimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve në AMF.
Rregullore nr. 14, datë 25.02.2009	"Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"	Qëllimi rregullores është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut, nga zyrtarët publikë të AMF-së, nëpërmjet përcaktimit të rregullave për lojtojt e interesave që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave.

Regullore nr. 114, datë 11.09.2008	"Për Konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"	Objekt i kësaj rregulloreje është klasifikimi, ruajtja dhe administrimi i informacionit jopublik në AMF.
Regullore nr. 61, datë 22.05.2008	"Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve"	Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme për trajtimin e ankesave të të siguruarve.
Regullore nr. 7, datë 30.08.2007	"Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare"	Kjo rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e administratës së AMF-së, detyrat funksionale të përgjithshme dhe të veçanta të çdo departamenti, drejtorie, sektori e punonjësi.
Regullore nr. 17, datë 21.03.2007	"Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare"	Kjo rregullore përcakton mënyrën e mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrave nga AMF, si dhe konsultimin e publikut me këto të dhëna.
Regullore nr. 3, datë 02.11.2006	"Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare"	Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve të anëtarëve të Bordit të AMF-së dhe marrëdhënieve midis këtyre të fundit dhe administratës së Autoritetit.
Udhëzim nr. 117, datë 29.08.2012,	"Për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve në punë të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"	Qëllim i këtij Udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe rregullave për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve të punës së punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Në Fushën e Sigurimeve


Referenca	Emërtimi	Përshkrimi
Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009	"Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"	Qëllim i këtij ligji është përmirësimi i bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm. Ky zhvillim ligjor ndërmerret në një kohë kur tregu i sigurimeve ka avancuar me shpejtësi dhe kërkohen ndryshime ligjore në përgjigje të këtij zhvillimi, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.
Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004	"Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime"	Objekt i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin pjesë për të ushtruar veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.
VKM nr. 5, datë 07.01.2009 propozuar me vendim Bordi nr. 166, datë 23.12.2008	"Për disa ndryshime në Vendimin nr. 96, datë 03.08.2008 të Këshillit të Ministrave "Për aktivet në mbullim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve"	Ndryshimet në VKM nr. 96, datë 03.08.2008, kanë për qëllim rritjen e kufirit të sipërm të lejueshëm për investimin e provigjoneve teknike e matematike në toka dhe ndërtime. I cili do të jetë në masën 30 %, nisur dhe nga mundësitë e kufizuara të investimit brenda vendit.
VKM nr. 164, datë 28.01.2008, propozuar me vendim Bordi nr. 3, datë 30.08.2007	"Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime"	VKM parashikon dispozita të përgjithshme ku krahas karakteristikave të licencës përcaktohen kufizime lidhur me aktivitetet e tjera detyruese që mund të ushtrohen vlerësuesi, të cilat sipas projektit duhet të jenë vetëm ato që ushtrohen në pajtim me natyrën e profesionit të tij.

VKM nr. 79, datë 28.01.2008 propozuar me vendim Bordin nr. 4, datë 30.08.2007	"Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime, si dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës"	VKM përcakton kriteret dhe procedurat për licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe në kriteret për licencimin e aktivitetit të agjentit në sigurime.
VKM nr. 96, datë 03.02.2008, propozuar me vendim Bordin nr. 3, datë 18.06.2007	"Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit"	VKM përcakton mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike si pjesën më të rëndësishme të përgjegjësisë të një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar detyrimet e tyre që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit.
VKM nr. 191, datë 25.03.2005	"Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë"	Në vendim përcaktohen mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbëjnë atë.
Rregullore nr. 126, datë 09.05.2012	"Për procedurat e ndalimit të përdorimit të lirë të pasurive të shoqërisë së sigurimit"	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë procedurat e ndalimit të përdorimit të lirë të pasurive të shoqërisë së sigurimit, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, nënshkruesve apo përfutuesve të kontratave të sigurimit.
Rregullore nr. 36, datë 21.03.2012 "	Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve"	Kjo rregullore përcakton rregulla në lidhje me administrimin e Fondit të Kompensimit.
Rregullore nr. 110, datë 28.07.2011	"Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Rregulorja përcakton nivelin e provigjoneve teknike, përmbajtjen e bazës teknike të të dhënave, metodikën për për llogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
Rregullore nr. 26 datë 23.02.2011	"Rregullore nr. 26, datë 23.02.2011 "Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg"	Rregulorja ka për objekt organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e procedurave të sistemit të raportimit AMF In-Reg.
Rregullore nr. 22, datë 19.03.2010	"Mbi krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve"	Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me administrimin e Fondit të Kompensimit.
Rregullore nr. 21, datë 19.03.2010	"Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të Kartonit Jeshil"	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat mbi administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil për të garantuar detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil dhe kriteret bazë të pajisjes së anëtarëve me certifikatë ndërkombëtare sigurimi, në momentin e aplikimit dhe në vazhdim.



Rregullore nr. 20, datë 19.03.2010	"Mbi masën e kontributit vjetor të shoqërive të sigurimit"	Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e masës së kontributit vjetor që i paguhet AMF-së nga shoqëritë e sigurimit ose dega e shoqërisë së huaj, gjatë ushtrimit të aktivitetit sigurues.
Rregullore nr. 2, datë 28.01.2010	"Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit"	Kjo rregullore përcakton rregullat dhe standardet e mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, përmbajtjen dhe afatet e raportimit të saj pranë Autoritetit.
Rregullore nr. 75, datë 28.08.2009	"Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Kjo rregullore përcakton nivelin e primeve e të provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përlogaritjen e primeve e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Ajo përcakton edhe procedurën dhe afatet për miratimin nga AMF të tabelave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
Rregullore nr. 67, datë 27.07.2009	"Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit"	Kjo rregullore përcakton kriteret dhe kushtet për dhënie dhe tërheqjen e autorizimit të aktuarit, si dhe përcaktimi i detyrave të tij.
Rregullore nr. 53, datë 25.06.2009	"Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e trajtimit të dëmeve, që mbulohen nga kontrata e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të njetit motorik, përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të avionit, përgjegjësisë së pronarit ose përdoruesit të mjetit lundrues.
Rregullore nr. 36, datë 30.04.2009	"Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike"	Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurat për raportimin e dëmeve të sigurimeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme.
Rregullore nr. 61, datë 22.05.2008	"Për procedurat e trajtimit të ankesave të siguruarve"	Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme për trajtimin e ankesave të të siguruarve.
Rregullore nr. 10, datë 03.10.2007	"Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik"	Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik, përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e AMF-së.
Rregullore nr. 2, datë 18.06.2007	"Për kriteret e risigurimit"	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshje risigurimi nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
Rregullore nr. 14, datë 08.02.2007	"Për disa kriteret që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit"	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizimin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërisë së sigurimit, si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.
Rregullore nr. 13, datë 08.02.2007	"Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënie të licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë"	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari si shogëri sigurimi ose risigurimi dhe degë e shogërisë së sigurimit të huaj, procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit, si dhe procedurat për licencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.
Rregullore nr. 9, datë 08.02.2007	"Mbi bazat, metodat e logaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetes"	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të Jo-Jetes nga shoqëritë e sigurimit.

Rregullore nr. 8, datë 08.02.2007	"Mbi bazat, metodat e logaritjes, si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike"	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra e logaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve matematike nga shoqëritë e sigurimit.
Rregullore nr. 7, datë 08.02.2007	"Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit"	Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktohen kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emrohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga AMF dhe përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar. Ndryshimet konsistojnë në periudhën që një shoqëri ekspertësh kontabël të jetë jo më e gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj.
